

PËRSHTATSHMËRIA E TË ARDHURAVE MINIMALE NË BE



EAPN SQARUES #2



PËRSHTATSHMËRIA E TË ARDHURAVE MINIMALE NË BE

EAPN SQARUES #2

2010



Ky botim është i përkrahur nga Programi i Komunitetit Evropian për Punësim dhe Solidaritet Social - PROGRESS (2007-2013).

Ky program udhëhiqet nga Drejtorati i Përgjithshëm për Punësim, Çështje Sociale dhe Mundësi të Barabarta, i cili është në kuadër të Komisionit Evropian. Është krijuar me qëllim që në mënyrë financiare ta përkrahë zbatimin e qëllimeve të Bashkimit Evropian në fushën e punësimit dhe çështjeve sociale, të përcaktuara në agjendën sociale, dhe me këtë të kontribuojë kah arritja e qëllimeve të Strategjisë së Lisbonit në këtë sferë.

Programi shtatëvjeçar i përfshin të gjithë aktorët të cilët mund të ndihmojnë në formimin e zhvillimit të punësimit adekuat dhe efektiv, si dhe legjislacionit dhe politikës sociale, në kuadër të BE-27, EFTA-EEA dhe kandidatët e BE-së, si dhe shtetet për t'u bërë candidate.

Misioni PROGRES ka për qëllim që ta përforcojë kontributin e BE-së për përkrahjen e detyrave të shteteve anëtare. PROGRES do të angazhohet për:

- *përgatitjen e analizave dhe këshillave për pjesëmarrësit në politikat e PROGRES-it;*
- *mbikqyrjen dhe raportimin për zbatimin e legjislacionit të BE-së dhe politikat në fushën e PROGRES-it;*
- *promovimin e transferit të politikave, mësimit dhe përkrahjen në mes shteteve anëtare lidhur me qëllimet dhe prioritetet e BE-së;*
- *shkëmbimin e mendimeve mes aktorëve dhe shoqërisë në përgjithësi.*

Për më tepër informata: <http://ec.europa.eu/progress>

Informatat e përmbajtura në këtë botim jo domosdo e reflektojnë pozitën ose mendimin e Komisionit Evropian.

Ky është botimi i dyti në serialin e manualeve të EAPN-ës të quajtura “Sqarues”, të cilat përpigën që në një gjuhë të kuptueshme dhe të përditshme t’i “sqarojnë” temat dhe debatet kryesore, të cilat janë prioritare në diskursin për varfërinë në BE. Ato u dedikohen kryesisht njerëzve të punësuar në organizatat e shoqërisë civile, mirëpo gjithashtu edhe secilit të interesuar për të kontribuar në progresin sa i takon uljes së varfërisë dhe përjashtimit social në BE. Ky serial i “Sqaruesve” është pjesë e aktiviteteve të EAPN-ës për rritjen e vetëdijes në vitin 2010, Viti Evropian për Luftë Kundër Varfërisë dhe Përjashtimit Social.

Mirënjohje për fotografitë:

Cover: Participant in the 8th European Meeting of People Experiencing Poverty, 2009, ©Rebecca Lee; As coisas têm preço, os homens têm dignidade, ©Sergio Aires; 17th October 2008, Brussels, ©Rebecca Lee; Mother and baby at EAPN’s GA in Vienna, 2009, ©EAPN Autriche. P 6: Family in tall grass, 26 April 2009, ©Seer Snively. P 9: Laugh and Dance, 5 August 2008.

©Holly Fisher. P 10: Man with microphone, Helsinki 2006, EAPN Finland. Mother and baby at EAPN’s GA in Vienna ©EAPN Autriche; Woman at EAPN’s GA in Vienna ©EAPN Autriche. P 12:

David and Ash love each other, 29 June 2009, ©Seer Snively. P 13: Esquisse de la précarité, ©EAPN France. P 14: Man on a wheelchair, ©European Commission. P 16: Heraanleg scheldekaainen, ©Raymond Clément. P 18: Explosions, Original artwork by Merrick Brown, July 2008, ©Merrick Brown. P 21: Let’s play, ©Emanuel Batalha. P 22: As coisas têm preço, os homens têm dignidade, ©Sergio Aires. P 28: Panier bio, 25 March 2006, ©Jalb. P 31: Complemento Solitario para Idosos ©Sergio Aires. P 32: Sábados ©Sergio Aires. P 39: 17th October 2008, Brussels, ©Rebecca Lee. P 40: Quimeras ©Sergio Aires. P 46: Porque sou eu eu e não tu, ©Sergio Aires. Back cover: Qui-meras ©Sergio Aires.

**EUROPEAN ANTI-POVERTY NETWORK
RÉSEAU EUROPÉEN DES ASSOCIATIONS DE LUTTE
CONTRE LA PAUVRETÉ ET L’EXCLUSION SOCIALE**

SQUARE DE MEEÛS, 18 – 1050 BRUSSELS
TEL : 0032 2 226 58 50 – FAX : 0032 2 226 58 69

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	9
1. PËR ÇFARË FLASIM?	13
1.1 Definicionet	13
1.2 Qasjet ndaj përshtatshmërisë nga ana e organizatave kundër varfërisë	16
2. REALITETI I (PA)PËRSHTATSHMËRISË	17
2.1 Çfarë thonë njerëzit	17
2.2 Faktet	18
Shumica e skemave për të ardhurat minimale nuk i nxjerrin njerëzit nga varfëria.....	18
Si llogariten dhe revidohen shumat në skemat për të ardhurat minimale?	20
Mosndërmarrja dhe mbrojtja e pamjaftueshme	23
3. LLOGARITJA E PËRSHTATSHMËRISË	25
3.1 Tregues të vobegësisë materiale: një qasje statistikore e BE-së për stilin joadekuat jetësor	25
Vlerësim i asaj që llogaritet për të qenë e domosdoshme për një jetë normale dhe të denjshme.....	26
Dy tregues të ri	26
Përparësitë dhe mangësitë e qasjes	28
3.2 Buxheti i standardit minimal për një jetë të denjshme në Britani	29
3.3 Model i shportës së shpenzimeve i bazuar në eksperiencat e njerëzve të cilët jetojnë në varfëri.....	31

3.4 Shfrytëzimi i buxhetit referent si standard gjatë krijimit të politikave: modeli i Suedisë	33
4. AVANCIMI NË KRIJIMIN E POLITIKAVE: SHEMBULLI I SHTYLLËS SË PENSIONIT	35
5. PËRSHTATSHMËRIA E TË ARDHURAVE MINIMALE GJATË KRIJIMIT TË POLITI KAVE SOT: SHEMBUJ NACIONAL TË REFORMAVE.....	37
5.1 Krijimi i 'revenu de Solidaritéactive' ('rSa') në Francë: zbatimi i Strategjisë për Përfshirje Aktive	37
5.2 Austri: Ligj i ri për të ardhurat minimale me testim	39
5.3 Finlanda: Reformimi i pensioneve dhe beneficioneve në vitin 2011	40
5.4 Belgjika: Një mjet i përgjithshëm – me planifikim kundër varfërisë	42
KONKLUDIM.....	44
SHTOJCA	45
SHTOJCA 1: NETO TË ARDHURAT TË PËRFITUESVE TË NDIHMËS SOCIALE (2006)	45
SHTOJCA 2: KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET KRYESORE NGA RA. PORTI I RRJETIT TË BE-SË I EKSPERTËVE TË PAVARUR PËR TË ARDHURAT MINIMALE NGA VITI 2009	46
SHTOJCA 3: DOKUMENTET DHE PROJEKTET KRYESORE LIDHUR ME PËR SHTATSHMËRINË E TË ARDHURAVE MINIMALE.....	49



Çfarë janë të ardhurat minimale?

‘Të ardhurat minimale’ është termi i cili zakonisht përdoret për ta përshkruar pagesën e cila bëhet nga shteti, e cila pagesë mundëson një ‘rrjet sigurie’ për njerëzit të cilët nuk mund të punojnë ose nuk kanë qasje në një punë të denjshme. Këto ‘të ardhura të shpresës së fundit’ ose ndihma sociale, është e drejtë sociale dhe një nga gurëthemelet e shtetit social, por edhe një bazë thelbësore për ta siguruar të drejtën e jetesës së denjshme për të gjithë. Aktualisht, skemat kombëtare ekzistojnë në shumicën e shteteve të BE-së (përveç Hungarisë, Italisë dhe Greqisë) dhe shteteve EFTA (përveç Norvegjisë).

Edhe pse karakteristikat e skemave për të ardhurat minimale ndryshojnë shumë nga shteti në shtet, një gjë është e qartë: **skemat ekzistuese për ‘të ardhurat minimale’ nuk janë** të mjaftueshme për t’i nxjerrë njerëzit nga varfëria, nuk i trajtojnë nevojat reale të njerëzve, dhe as që i mundësojnë ato që në mënyrë të barabartë të marrin pjesë në bashkësitë ose shoqërinë e tyre. Në plotësim, skemat për të ardhurat minimale për momentin ballafaqohen me kërcënime të shumëfishta: çmimet e rritura e shtypin fuqinë e tyre blerëse, politikat për tregun aktiv të punës e rrisin kushtëzimin e përfitimeve; njerëzit me të ardhura minimale vazhdimisht e më shumë etiketohen si përtacë dhe janë të stigmatizuar për shkak të asaj që janë receipientë të këtyre përfitimeve.

E drejta për të ardhura minimale të përshtatshme është kërkesa kryesore nga lëvizja kundër varfërisë; të sigurohet një standard i pranueshëm dhe i denjshëm i jetesës për të gjithë. Debatë aktual fokusohet në atë se si mund të ndërtohet dhe zbatohet një standard i të ardhurave minimale nëpër të gjithë BE-në.

Përse është përshtatshmëria e rëndësishme?

Ka argumente të forta të cilat e përkrahin nevojën për një nivel të lartë të të ardhurave minimale:

- Skemat për të ardhura minimale janë instrumenti kyç për parandalimin e varfërisë dhe përjashtimit social, vetëm atëherë nëse nivelet janë të mjaftueshme për t’i nxjerrë njerëzit nga varfëria.
- Ato u’a japin njerëzve të prekshëm sigurinë afat-gjate për të cilën ato kanë nevojë për t’u angazhuar në rrugëtimet e punësimit, pjesëmarrjes më të madhe sociale ose mundësive të tjera për përfshirje.
- Ato e sigurojnë përfshirjen sociale të njerëzve për të cilët punësimi nuk është një alternativë, qoftë për shkak të hendikepit, sëmundjes afat-gjate ose problemeve me shëndetin mental, moshës ose angazhimeve familjare, ose atje ku vendet e punës kualitative nuk janë të disponueshme.
- Ato janë katalizatori për rroga të ndershme atëherë kur niveli i rrogave është i ndërlidhur me një hierarki pozitive me nivelet e denjshme të të ardhurave minimale.
- Shtetet anëtare më janë zotuar që në nivel të BE-së ose në nivel ndërkombëtar të sigurojnë të ardhura të përshtatshme, mirëpo zbatimi i këtyre zotimeve ka qenë i dobët.
- Mbi të gjitha, ato mundësojnë një bazë solide për një shoqëri socialisht kohezive, të ndërtuar mbi solidaritetin.
- Në krizën aktuale ekonomike, ato jo vetëm që i parandalojnë vështirësitë për ato të cilët janë të papunë, por mundësojnë një bazë thelbësore që shpenzimet e konsumatorëve ta rrisin ekonominë.

Përse një sqarues mbi përshtatshmërinë e të ardhurave minimale tani?

Që nga viti 1992, shtetet anëtare (SHA) publikisht janë zotuar që të sigurojnë të ardhura minimale të përshtatshme për një jetë të denjshme.¹ Në dhjetor, 2008, ministrat e BE-së për Çështje Punësimi dhe Sociale e miratuan rekomandimin e Komisionit “Të bartet përfshirja aktive e njerëzve tej tregut të punës” e cila përfshinte:

1. *Parashikimin e një niveli të përshtatshëm të përkrahjes në para*
2. *Link me tregun e punës*
3. *Qasje në shërbime, dhe në veçanti në shërbimet sociale.*²

EAPN bën një fushatë për zbatimin konkret të këtyre zotimeve. Që të përshpejtohet zbatimi i Rekomandimit, një varg aktiviteteesh u planifikuan nga Komisioni në vitin 2009. Kjo përfshin një studim për **të ardhurat minimale në BE**, i përpiluar nga rrjeti i ekspertëve kombëtar për përfshirje sociale i BE-së³ dhe i botuar në tetor, 2009. U kërkuar nga ekspertët kombëtar që t'i vlerësojnë skemat kombëtare të të ardhurave minimale sa i takon përfshirjes së tyre, përshtatshmërisë dhe efikasitetit, si dhe rolin e tyre në strategjitë e integruara për përfshirje sociale. Analizat në këtë raport janë të përafërta me pozitën e EAPN-ës dhe ne i përkrahim shumë konkludimet dhe rekomandimet të cilat përmbahen në këtë raport. EAPN shpreson që ky ky raport të nxisë progres të mëtutjeshëm sa

i takon krijimit të standardeve për të ardhurat minimale në nivel të BE-së, edhe atë përmes EU Social Open Method of Coordination (Metodës Sociale të Hapur të Koordinimit të BE-së)...

Së fundi, në kontekst të krizës ekonomike, BE-ja i ka shtyrë qeveritë ta njohin rolin e dyfishtë të mbrojtjes sociale në zbutjen e ndikimit social dhe mundësimin e një leve për ta rritur kërkesën e konsumatorit, të gjitha në dobi të mëkembjes së ekonomisë.⁴ Kjo do të thotë se skemat për të ardhurat minimale aktualisht janë fokusi i interesit të gjallëruar nga ana e krijuesve të politikave. Në një rast të Këshillit Evropian, në pranverën e vitit 2009, SHA u pajtuan se “ndërlidhja mbi solidaritetin dhe lejimi i sistemeve të mbrojtjes sociale që krejtësisht ta luajn rolin e tyre si stabilizues automatik janë kyçe për rikthimin dhe përf forcimin e besimit, por edhe ndihmojnë që të shtrohet rruga për rigjenerim”.⁵

Sot, varfëria drejtëpërdrejt përfshin së paku 79 milion njerëz në BE. Ç'rregullimi ekonomik gjeneron më shumë papunësi dhe e rrit numrin e njerëzve të cilët janë në rrezik nga varfëria. Skemat për të ardhurat minimale të cilat janë të përcaktuara mbi pragun e varfërisë dhe në një nivel i cili lejon jetën e denjshme, do të kenë një ndikim të rëndësishëm për një numër të njerëzve të cilët janë në rrezik nga varfëria. Tani është koha që të sigurojmë prezencën e skemave për të ardhurat minimale në të gjitha shtetet anëtare dhe në një nivel në të cilin njerëzit mund të jetojnë një jetë të denjshme dhe të marrin pjesë në shoqëri.

1. Shih rekomandimet e Këshillit 92/441/CEE të 24 qershorit, 1992 për kriteret e përbashkëta sa u takon resurseve të mjaftueshme dhe ndihmës sociale në sistemet për mbrojtje sociale në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31992H0441:EN:HTML>

2. Shih reagimin e EAPN për rekomandimin e Komisionit lidhur me Përfshirjen Sociale në <http://www.eapn.eu/content/view/576/29/lang.en>

3. Në kuadër të aktiviteteve të Metodës së Hapur Sociale për Koordinim të BE-së, rrjeti i ekspertëve të pavarur për përfshirje sociale çdo vit jep raporte për çdo shtet, si dhe një raport sintetik/të përbashkët. Shih raportet e ekspertëve kombëtar dhe raportin e sintetik Skemat për të Ardhurat Minimale në Shtetet Anëtare të BE-së, Raport Sintetik nga Hugh Frazer dhe Eric Marlier, tetor, 2009, në ueb faqen për Shqyrtim të Barabartë të Përfshirjes: <http://www.peer-review-social-inclusion.eu/network-of-independent-experts/2009/minimum-income-schemes>

4. Shih Komunikatë nga Komisioni Evropian Një Plan Evropian për Mëkëmbje Ekonomike, nëntor, 2008 në: http://ec.europa.eu/economy_finance/publications/publication13504_en.pdf

5. Shih konkludimet e Këshillit Evropian në mars të vitit 2009 http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/106809.pdf dhe reagimin e EAPN-ës për Konkludimet Pranverore të Këshillit në: <http://www.eapn.eu/content/view/834/29/lang.en>

Çfarë do t'ju tregojë ky sqarues?

Të ardhurat e përshtatshme mund të vijnë nga një numër i burimeve: rroga, pensione, përfitime sociale ... EAPN e mbron të drejtën për të ardhura minimale të përshtatshme për një jetë të denjshme përgjatë ciklit jetësor, duke përfshirë rroga të denjshme dhe pensione adekuate. Megjithatë, ky manual parimisht ka për qëllim që të japë një prezantim për çështjen e **përshtatshmërisë së të ardhurave minimale nga ndihma sociale, dhe jo nga këto burimet e tjera** dhe atje ku është e nevojshme vetëm do t'i bëjë referencë të vogël çështjes së rrogave dhe pensioneve.

Përpiqemi t'ju përgjigjemi pyetjeve të ardhshme kryesore:

- *Çfarë do të thotë përshtatshmëria? Si llogaritet përshtatshmëria? (Kapitulli 1)*
- *Sa janë të përshtatshme nivelet e të ardhurave aktuale minimale për njerëzit të cilët e përfetojnë varfërinë në realitet? (Kapitulli 2)*
- *A ka shembuj të praktikave të mira për llogaritjen më të mirë të përshtatshmërisë? Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e tyre (Kapitulli 3)*

- *Cila është rruga për avancim në politik-bërje? (Kapitulli 4)*
- *Si trajtohet përshtatshmëria në reformat aktuale të sistemeve kombëtare për mbrojtje sociale? (Kapitulli 5)*

Është e qartë se përshtatshmëria e një niveli të të ardhurave është shumë e ndërlidhur me qasëshmërinë në shërbimet kryesore në terren. Një nivel relativisht i lartë i të ardhurave minimale mund të dëshmohej si i pamjaftueshëm në kushte kur shërbimet bazike janë të shtrenjta. E kundërta e kësaj është ajo se qasëshmëria e shërbimeve bazike e rrit fuqinë blerëse të skemave me të ardhura të ulta minimale. Edhe pse sqaruesi aktual nuk mundet ta adresojë në detale çështjen e qasëshmërisë së shërbimeve, ne do t'i shqyrtojmë mënyrat për vlerësimin e fuqisë blerëse konkrete të të ardhurave minimale në kontekste të caktuara kombëtare, që zakonisht varet nga qasëshmëria dhe kualiteti i shërbimeve.





PËR ÇFARË FLASIM? DEFINICIONET, BAZA LIGJORE DHE REALITETI

1.1. Definicionet

Të ardhurat minimale

Shumica më e madhe e Shteteve Anëtare mundësojnë **skema** për të ardhura minimale. Këto janë 'rrjete sigurie' bazike të cilat zakonisht **nuk burojnë nga kontributet (d.m.th. nuk mbështeten në kontributet që burojnë nga pagat e njerëzve), skema për ndihmë sociale për përfitues të testuar** të cilat kanë për qëllim të garantojnë të ardhura për personat të cilët nuk mund të mbështeten në asnjë formë tjetër të të ardhurave. Këto skema të shprehës së fundit janë litari shpëtimtar për më të varfërit në Evropë. Ato duhet të jenë në një nivel të mjaftueshëm që të mundësojnë më shumë se sa vetëm një mbijetesë të thjeshtë, të mundësojnë pjesëmarrje në shoqëri dhe duhet të jenë bazë për një jetë stabile.

Skemat për të ardhurat minimale dallojnë nga burimet kontribuese të të ardhurave në shtetet sociale, siqë janë skemat e pensioneve dhe përfitimit për papunësim, ku kontributet financiare minusohen nga punëdhënësit dhe të punësuarit kur ato janë duke punuar. Në disa raste, njerëzit mund të përfitojnë nga një përkrahje e të ardhurave minimale nga degët e ndryshme të përfitimeve të mirëqenies dhe ato sociale (për shembull në Francë "Revenu de Solidarité Active"

është ndihmë shtesë: vjen në krye të burimeve të tjera të të ardhurave për t'u siguruar që të ardhurat e njerëzve ta arrijnë prapen minimal).

Për momentin nuk ka një definicion të saktë për të ardhurat minimale për të gjitha shtetet anëtare. Në varësi të shteteve dhe regjioneve u jepen edhe tituj të ndryshëm. Kjo shihet në llojllojshmërinë e sistemeve nacionale dhe politikave të mbrojtjes sociale. Instrumentet ndërkombëtare dhe ato të BE-së u referohen vetëm parimeve të përgjithshme (shih më poshtë) dhe i përdorin frazat "përkrahje në të ardhura", "resurse dhe përfitime"; kjo e reflekton edhe vështirësinë për të ndërtuar një qasje të përbashkët në nivel të BE-së.

Vërejtje: Të ardhurat minimale nuk duhet të ngatërrohen me **rrogën minimale**, që është niveli minimal i rrogës i përcaktuar me ligj ose me anë të marrëveshjeve kolektive.

Është gjithashtu e ndryshme nga idea për një 'të ardhur bazike', e promovuar nga disa hulumtues, që janë të ardhura të cilat u miratohen pa kushtëzime të gjithëve në baza individuale, pavarësisht të të ardhurave nga lloje tjera të burimeve, pa kurrëfar kushte për punë. Sot në botë, shembulli unik dhe konkret i të ardhurave bazike të pastra është skema e Alaskës e dividendave vjetore të naftës.⁶

6. Për më tepër informata lidhur me të 'ardhurat bazike' shih ueb-faqen e Basic Income Earth Network: <http://www.basincome.org/bien/aboutbien.html>



Përshtatshmëria

Nocioni i përshtatshmërisë së të adhurave minimale siqë kuptohet dhe përdoret në nivel të BE-së është i definuar në instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe ato të BE-së.

Rekomandimi i Komisionit të BE-së, i miratuar në tetor të vitit 2008 thotë se “një përkrahje e përshtatshme në të ardhura” duhet të jetë e “mjftueshme për të bërë një jetë e cila është e kompatibile me dinjitetin njerëzor”. Ky rekomandim gjithashtu e rritet nocionin e rekomandimit të miratuar nga Këshilli i BE-së në vitin 1992, mbi të cilën edhe thirret.

Baza kryesore ligjore: Rekomandimi i Këshillit i vitit 1992

Referenca kryesore në kontekst të BE-së është Rekomandimi i Këshillit 92/441/EEC⁷ “për kriteret e përbashkëta sa u takon resurseve dhe ndihmës sociale të mjaftueshme në sistemet e mbrojtjes sociale”;

të përcaktuar në fund të programit shkëmbyes transnacional Poverty III. Ky rekomandim i fton shtetet anëtare (SHA) të miratojnë “një të drejtë fundamentale për burime të mjaftueshme dhe të besueshme, si dhe përfitime, dhe t’i përshtasin sistemet e tyre për mbrojtje sociale në pajtim me këtë”, sipas parimeve të ardhshme të përbashkëta, nga të cilat i pari është e drejta e cila bazohet në **respektimin e dinjitetit njerëzor**.

Rekomandimi hyn në detaje për atë se si shtetet anëtare duhet të sigurojnë përshtatshmërinë e këtyre resurseve:

*“- shumën e resurseve të mjaftueshme për t’i mbuluar nevojat esenciale përcaktohet sipas **standardit jetësor dhe nivelet e çmimeve për lloje dhe madhësi të ndryshme të amvisërive**;*

*Mund të përcaktohen shumën suplementare për t’i përmbushur **nevojat specifike (...)**”*

Edhe pse përbën një nxitës të fortë për të krijuar skema për të ardhura minimale në nivel kombëtar, rekomandimi e len zbatimin në duart e shteteve anëtare, në bazë të parimit të subsidiarizmit i cili aktualisht zbatohet për çështje të ndërlidhura me mbrojtjen sociale në nivel të BE-së.

Ky zotim i vitit 1992 është riafirmuar nga një “Rekomandim i Komisionit” i miratuar më 17 tetor 2008, dhe i vërtetuar nga Këshilli i EPSCO⁸ në dhjetor të vitit 2008,⁹ duke kërkuar nga SHA që t’i “rishqyrtojnë sistemet e tyre të mbrojtjes, në bazë të nevojave, lidhur me parimet e përbashkëta të përvijuara në paragrafin B të Rekomandimit 92/441/EEC”.

Rekomandimi i vitit 1992 është një element kyq nga konteksti ligjor i cili karakterizohet nga një sërë e marrëveshjeve ndërkombëtare në favor të zbatimit të kësaj të drejte fundamentale.

7. Shih Rekomandimin e Këshillit të vitit 1992 mbi Përfshirjen Inkluzive në:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31992H0441:EN:HTML>

8. Këshilli për Punësim, Politikë Sociale dhe Çështje Konsumatori.

9. Shih Konkludimet e Këshillit të datës 17 dhjetor 2008 në: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/en/lsa/104818.pdf

Korniza ligjore: Çfarë thonë marrëveshjet ndërkombëtare për përshtatshmërinë e të ardhurave minimale?

Shumë zotime të tjera ndërkombëtare dhe evropiane e njohin të drejtën e të gjithëve për të ardhura minimale, të mjaftueshme për ta avancuar standardin e denjshëm të jetesës, si një çështje e respektimit të dinjitetit njerëzor, dhe si mënyrë për ta luftuar varfërinë dhe përjashtimin social.

Kombet e Bashkuara: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut 1948, e rikonfirmuar në Konferencën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut 1993 dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të vitit 1966 – Neni 25 thotë se *“Secili ka të drejtë që të ketë një standard të përshtatshëm për jetesë për shëndetin dhe mirëqenien e vetes dhe familjes së tij, duke përfshirë ushqim, veshje, banim dhe kujdes mjekësor...”*

Karta Sociale Evropiane e Këshillit të Evropës (versioni i reviduar, 1966): neni 13 thotë se *“Secili i cili nuk ka resurse të përshtatshme, ka të drejtën e ndihmës sociale dhe mjekësore”*.

Karta e Komunitetit për të Drejtat Fundamentale të Punëtorëve (1989) në paragrafin 10 përcakton se *“Personat të cilët nuk kanë qenë të aftë për të hyrë ose ri-hyrë në tregun e punës dhe nuk kanë mjete për të mbijetuar duhet të kenë mundësi që të marrin mjete të mjaftueshme dhe ndihmë sociale (...)”*

Karta e të Drejtave Fundamentale e BE-së (2000) në nenin 1 thotë se *“dinjiteti njerëzor është i pathyeshëm. Duhet të mbrohet dhe respektohet.”* Neni 34, Paragrafi 3, përcakton se *“Me qëllim që të tejkalohet përjashtimi social dhe varfëria, Unioni e njeh dhe e respekton të drejtën e ndihmës sociale dhe banuese, për të siguruar një ekzistencë të denjshme për të gjithë ato të cilët kanë mungesë të resurseve të mjaftueshme (...)”*

Karta e të Drejtave Fundamentale e BE-së¹⁰ tani është me ligj e detyrueshme, si pjesë e Traktatit të Ri Reformues, e miratuar nga të gjitha shtetet anëtare dhe ka hyrë në fuqi nga 1 dhjetor, 2009.

10. Për më tepër informata shih në Kartën e të Drejtave Fundamentale të BE-së, në ueb-faqen e Parlamentit Evropian:

http://www.europarl.europa.eu/charter/default_en.htm





1.2. Qasjet ndaj përshtatshmërisë nga ana e organizatave kundër varfërisë

Përderisa definicionet ligjore të BE-së dhe ato ndërkombëtare janë pika referente vitale e teorisë, zbatimi i tyre konkret u është lënë niveleve kombëtare dhe lokale. Sa efektive janë ato në terren? Raporti sintetik i vitit 2009 për Skemat e të Ardhurave Minimale nëpër BE nga Rrjeti i Ekspertëve të Pavarur Kombëtar për Përfshirje Sociale të BE-së ('2009 Raporti Sintetik i Ekspertëve Kombëtar') e nënvizon *"realitetin, që është se shumica e shteteve anëtare nuk e theksojnë çështjen e përshtatshmërisë dhe nuk kanë definuar çfarë, në kontekstet e tyre kombëtare dhe regjionale, do të duhet të jenë të ardhurat e përshtatshme minimale për ta siguruar të drejtën e një personi për të jetuar një jetë të denjshme"*.

Disa akademikë dhe aktivistë kundër varfërisë kanë bërë propozime për atë sesi përshtatshmëria mund të definohet dhe zbatohet më konkretisht.

Çështja e përshtatshmërisë së të ardhurave në mënyrë të posaçme është shqyrtuar në studimet anglo-saksoneze. John Veil-Wilson thotë se "përshtatshmëria e ndihmës në të ardhura nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte, por të kuptohet vetëm në mënyrë konkrete. Ai thotë se *"fjala 'e përshtatshme' do të thotë e mjaftueshme*

për qëllimin", dhe propozon që të përdoren **katër pyetjet e ardhshme:**

- **E përshtatshme për çfarë?**
- **E përshtatshme për cilin?**
- **E përshtatshme për sa kohë?**
- **Kush thotë se është e përshtatshme?**

Një projekt transnacional "Drejtë një iniciative të BE-së për standardet sociale"¹³ grumbulloi hulumtues, OJQ, duke përfshirë edhe EAPN-ën, si dhe aktorë publik gjatë dy viteve dhe punoi në të ardhurat minimale, si një fushë e mundshme për themelimin e standardeve minimale në nivel të BE-së. Projekti e ka theksuar rëndësinë e shumë dimensionalitetit të varfërisë, dhe i ka përvijuar kuptimet e ndryshme të përshtatshmërisë të cilat duhet të merren parasysh:

- nga aspekti i të ardhurave ("sa është e mjaftueshme?");
- nga aspekti i përfshirjes së popullatës dhe qasëshmërisë së disa skemave ekzistuese;
- nga aspekti i zgjidhjeve politike të propozuara për ta trajtuar problemin;
- nga aspekti i përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara.

Me të vërtetë, të gjitha dimensionet e lartpërmendura janë kyçe për t'ju afruar realitetit të përshtatshmërisë së përkrahjes së ofruar për më të prekshmit. Veçanërisht, qasëshmëria – posaçërisht qasëshmëria dhe kualiteti i **shërbimeve në interes të përgjithshëm**, duke përfshirë edhe shërbimet sociale, por gjithashtu transportin, energjinë, shërbimet për punësim publik, shërbimet financiare etj... kanë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi fuqinë blerëse dhe kualitetin e jetës së njerëzve në pyetje.

11. <http://www.peer-review-social-inclusion.eu/network-of-independent-experts/2009/minimum-income-schemes>

12. John Veil Wilson, *Why money matters: family income, poverty and children's lives* / edited by Jason Srelitz and Ruth Lister, London: Save the Children, 2008. Shih gjithashtu punimet hulumtuese të përpiluara nga John Veit-Wilson për varfërinë, pabarazinë, humbjen, përjashtimin social, standardet për të ardhurat minimale në: <http://www.staff.ncl.ac.uk/j.veil-wilson/>

13. *"Making a decisive impact on the eradication of poverty. Towards an EU initiative on social standards"*, Report nga projekti transnacional, 2007.

REALITETI I (PA) PËRSHTATSHMËRISË

2.1. Çfarë thonë njerëzit

Realiteti është larg nga arritja e kriterëve të përshtatshmërisë të përcaktuara me Rekomandimet e vitit 1992. Ajo se çfarë njerëzit e rrezikuar nga kjo dijnë, dhe se çfarë të dhënash statistikore dhe studimet tregojnë, është se shumica e të ardhurave minimale janë krejtësisht joadekuata për t'i përmbushur këto kriterë. Ato nuk lejojnë qasje adekuata në banim, ushqim të shëndoshë, ngrohje të përshtatshme, kujdes shëndetësor kualitativ, as po pjesëmarrje në jetën sociale dhe kulturore... Njerëzit të cilët duhet të mbështeten në këto skema ballafaqohen me vështirësi në shumë ose të gjitha aspektet e jetës së tyre.

Citatet e ardhshme japin një fotografi për realitetin e jetës së njerëzve të cilët jetojnë me të ardhura minimale.¹⁴

Të ardhurat minimale nuk e hapin derën e një jete të denjshme:

"Të ardhurat minimale, u mundësojnë juve që të mbijetoni, jo të jetoni."

*"Nuk mund të jem i shoqërueshëm. Vetëbesimi im është prishur, për shkak se çdo ditë unë duhet të brengosem për ditën e ardhshme."*¹⁵

"Ndjehesha i turpëruar nga ajo që jam përfitues i të ardhurave të garantuara minimale. Çdoherë desha të punoj dhe dua të ndjehem i dobishëm."

Të ardhurat minimale nuk janë as të mjaftueshme për t'i adresuar nevojat esenciale:

"Unë mundem të blej vetëm ushqim të lirë. Frutat dhe perimet për t'i ushqyer fëmijët janë tepër të shtrenjta, ushqimi i shëndoshë është shumë i shtrenjtë për mua."

"Me vetëm të ardhura minimale ju nuk mund ta paguani qiranë."

"Shohim rritje të çmimeve të ushqimit, të çmimeve të rrymës, rritje të përgjithshme në shpenzimet e jetesës, por jo edhe përshtatshmëri esenciale në përfitimet sociale ose pensionet."

"Të jetuarit me të ardhura minimale, është më e keqe se mbijetesat. Nëse nuk kërkon para nga ato rreth jush, nuk mund ta përfundoni muajin."

Të ardhurat minimale nuk e parandalojnë varfërinë:

"Gjëja e mirë e skemës së të ardhurave minimale është se e njëjta ekziston por nuk e zgjedh varfërinë."

14. Në rast se nuk specifikohet ndonjë burim tjetër, këto citate vijnë nga puna përgatitore dhe shkëmbimet gjatë Takimeve të Njerëzve të cilët e përjetojnë varfërinë. Takimet e njerëzve të cilët e përjetojnë varfërinë janë organizuar që nga viti 2001 nën Prezidentat e njëpasnjëshme të BE-së, me përkrahje të EAPN-ës. Ato i grumbullojnë njerëzit të cilët ballafaqohen me varfërinë nga të gjitha shtetet e BE-së, të cilët i shkëmbejnë gjatë këtyre takimeve brengat dhe kërkesat e tyre në gjuhën e tyre amë. Takimi i vitit 2008 fokusoheshte në të ardhurat minimale si një nga shtyllat në luftën kundër varfërisë. Shih informata në <http://www.eapn.eu/content/view/13/14/lang.en>.

15. *Voices from the poverty line*, EAPN, 2006: Shih <http://www.eapn.eu/content/view/127/84/lang.en>



"Të ardhurat minimale janë shpesh nën prapun e varfërisë."

Shuma e të ardhurave minimale nuk bazohet në nevojat e njerëzve por në kritere arbitrare:

"Përfitimet nga të ardhurat minimale gjerësisht ndryshojnë – ato janë si një lotari postale."

"Fakti që a jeni ju në mënyrë adekuate të ushqyer ose jo përcaktohet nga ajo se në cilën komunë jetoni dhe kjo është vetëm edhe një faktor me të cilin ndjehet padrejtësia, braktisja dhe përjashtimi social".

Disa nuk fitojnë kurrëfar të ardhura:

"Njerëzit e rinj në moshë 18-25, nuk kanë të drejtë në asgjë."

"Njerëzit e rinj duhet të hibernojnë deri në moshën 25 vjeçare!"

"Të huajt, edhe me vizë, ballafaqohen me vështirësi të mëdhaja gjatë kërkesës së të ardhurave minimale."

Disa e kanë humbur të drejtën e të ardhurave për shkak se nuk i kanë përmbushur kushtet e përcaktuara, siqë është kërkesa e punës: *"U ndjeva shumë keq. Ishte një shok total. Nuk kisha kurse dhe përfitimet ishin të ardhurat e mija të vetme. Nuk kisha para për ushqim ose nxemje".*¹⁶

2.2. Faktet

Shumica e skemave për të ardhurat minimale nuk i nxjerrin njerëzit nga varfëria

Skemat për të ardhurat minimale ndryshojnë shumë prej një shteti në tjetër. Niveli i zemërgjerësisë së tyre është variabla e parë.¹⁷ Por, në të gjitha shtetet anëtare, nivelet janë larg nga ajo për t'i nxjerrë njerëzit nga varfëria.

Brenda BE-së, njerëzit të cilët marrin më pak se 60% të të ardhurave mediane llogariten për të qenë 'në rrezik të varfërisë'.¹⁸ Një dokument punues i Komisionit, i publikuar në vitin 2008¹⁹ i krahason neto të ardhurat e amvisërive të papuna të cilat mbështeten ekskluzivisht në përfitimet e ndihmës sociale dhe përfitimet për banim në nivelin e vijës zyrtare të varfërisë (p.sh. 60 % nga të ardhurat mediane të amvisërisë).

Ky krahasim tregon se vetëm disa shtete i paisin amvisëritë e papuna me të ardhura minimale dhe përfitimet e ndërlydhura të cilat janë të mjaftueshme për t'i ngritur ato afër ose mbi prapun e 60% të të ardhurave mediane (p.sh. pragu i varfërisë), dhe kjo vetëm për disa lloje të familjeve. (Shih tabelën 1 në Shtojcën 1)

16. Shih Voices from the poverty line, EAPN, 2006 në: <http://www.eapn.eu/content/view/127/84/lang.en>

17. Shih Trends, Recent Developments, Active Inclusion and Minimum Resources, Synthesis report of the independent review based on national reports from independent experts, first semester 2006, në: <http://www.peer-review-social-inclusion.eu/network-of-independent-experts/2006/first-semester-2006>

18. Të ardhurat mediane për amvisëritë i ndajnë amvisëritë në dy segmente të ngjajshme, ku gjysma e parë e amvisërive fitojnë më pak se të ardhurat mediane të amvisërive dhe gjysma tjetër fiton më shumë. Shih më tepër sqarime në EAPN Explainer on poverty at: <http://www.eapn.eu/content/view/998/84/lang.en>

19. Види го работниот документ на вработените на Комисијата: Monitoring progress towards the objectives of the European Strategy for Social Protection and Social Inclusion, October 2008, стр. 53 на: http://ec.europa.eu/employment_social/spsi/docs/social_inclusion/2008/omc_monitoring_en.pdf

Ky dokument na tregon se:

- *Prindërit e vetëm mund të fitojnë ndihmë sociale dhe beneficione të ndrlidhura (p.sh. beneficione banuese) në nivel të ose mbi prapun e varfërisë në Latvi, Gjermani, Danimarkë, Mbretërinë e Bashkuar, Irlandë dhe Holandë.*
- *Në të gjitha shtetet veç Latvisë, Gjermanisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës, çiftet me dy fëmijë të cilat mbështeten në beneficione e ndihmës sociale do të kenë vetëm një të ardhur e cila do të jetë nën prapun e varfërisë.*
- *Në Sllovaki, Maltë, Estoni dhe Spanjë, të gjitha tre llojet e familjes ka gjasa që të përjetojnë varfëri të keqe me të ardhurat jashtë punës të cilat janë nën 60% nga prapu i varfërisë.*
- *Të tre llojet e familjes fitojnë së paku 60% nga vija e të ardhurave mesatare (p.sh. 100% nga pika e varfërisë) vetëm në 2 shtete (Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda).*
- *Personat e vetëm marrin më pak se 60% nga pragu i varfërisë në 7 shtete (Lituani, Sllovaki, Portugali, Maltë, Estoni, Hungari dhe Spanjë) dhe së paku 60% nga pika e të ardhurave mesatare (d.m.th. 100% nga pragu i varfërisë) në vetëm 6 shtete në BE (Finlandë, Suedi, Danimarkë, MB, Irlandë, Holandë).²⁰*

Këto konkludime bazohen në një simulim për rrjetin minimal të sigurisë, i cili sigurohet për amvisëritë pa shtëpi, duke e shfrytëzuar metodën e OECD-ës për lehtësimet tatimore. Prandaj edhe ato e reflektojnë gjendjen teorike. Në realitet, të ardhurat sociale të cilat njerëzit i fitojnë janë shumë më të vogla.

E vërtetë është se mbrojtja sociale së paku e zbut varfërinë: sikur të mos ekzistonte transferi social i mjeteve, rreziku mesatarë i varfërisë për shtetet anëtare do të jetë 26%, kundrejt 16% pas marrjes

së mjeteve shtetërore. Mirëpo kjo ende nuk është e mjaftueshme: më tepër se 84 milion njerëz në BE janë lënë nën prapun e varfërisë.

Vlerësimi nga Raporti i sintetik i ekspertëve kombëtarë,²¹ i bërë në vitin 2009 është se **“në shumicën e shteteve, skemat për të ardhurat minimale nuk arrijnë që të gjithë njerëzve t’u ofrojnë një jetë të denjshme, dhe një numër i madh i tyre janë shumë të shkurtëra.”**

Këto të dhëna për varfërinë përfshijnë realitete të ndryshme:

Është e qartë se të jetuarit në prapun e varfërisë nuk nënkupton standard të njejtë të jetesës në çdo shtet anëtar të BE-së. Pragjet nacionale të atyre në rrezik të varfërisë janë gjithashtu të theksuara nga ana e Eurostat-it në **‘Purchasing Power Parties’ (PPP)**. PPP janë hapa të valutës së ndryshueshme që i ndryshon treguesit ekonomik të cilët janë të theksuar në valuta kombëtare, ndërsa valuta e përbashkët i merr parasyshë dalimet në nivelin e çmimeve dhe kështu mundëson krahasime. Kjo do të thotë se kur krahasohen pragjet nacionale të rrezikut nga varfëria të theksuara në PPP, në fakt mund të krahasohet fuqia reale blerëse e njerëzve të cilët jetojnë në prapun e varfërisë jashtë kufirit të shtetit. Pragjet e rrezikut të varfërisë të theksuara në PPP lëvizin prej 1765 në një vit në Romani deri më 17575 në vit në Luksemburg. **Kjo do të thotë në realitet se standardi i njerëzve të cilët jetojnë me 60% të ardhura mesatare (në rrezik për të jetuar në varfëri) në Luksemburg është rreth dhjetë herë më shumë nga ai i njerëzve në rrezik nga varfëria në Romani.** (Megjithatë, varfëria nuk ka të bëjë vetëm me mungesat materiale, por është e ndërlidhur me mundësinë për të marrë pjesë në shoqërinë në të cilën jetojmë (shih EAPN Sqaruesin për sqarime lidhur me varfërinë)).²²

20. Idem 3.

21. Idem 3.

22. http://www.eapn.eu/index.php?option=com_content&view=article&id=33&Itemid=52&lang=en

Si llogariten dhe revidohen shumatat në skemat për të ardhurat minimale?

Si llogariten shumatat e të ardhurave minimale?

Në vitin 2006, një raport ekspertësh i porositur nga Komisioni Evropian²³ i paraqiti filozofitë e ndryshme të cilat i përkrahin marrëveshjet për aprovimin e të ardhurave minimale në nivel kombëtar. Raporti bëri dallim mes shteteve anëtare siqë është **Suedia**, me qëllim që të përfshihet popullata e tërë në një sistem të përgjithshëm të mirëqenies, dhe si Danimarka e cila ka një qasje shumë të defokusuar, duke u orientuar kah grupet specifike të marginalizuara.

Ato gjithashtu e theksuan ndikimin e llojeve të politikave familjare të zbatuara në nivel kombëtar.

Në shumicën e shteteve anëtare, shumatat e të ardhurave minimale është fikse dhe **përcaktohet nga pushtetet qendrore**. Në disa

shtete anëtare, dispozitat janë të fiksuara në nivel nën-nacional: në nivel të regjioneve autonome, si për shembull në Spanjë dhe Itali. Në këtë rast, dallimet regjionale mund të jenë të mëdha: siqë është për shembull në Spanjë, ku niveli i të ardhurave minimale lëviz prej 285 deri më 585 euro në vitin 2007.²⁴ Në **Suedi**, të ardhurat minimale janë të ndara mes pushteteve nacionale dhe atyre regjionale për elemente të ndryshme: për shembull, për disa punë shumatat përcaktohet në nivel kombëtar, për të tjera kërkohet që komunat t'i

paguajnë shpenzimet reale jetësore (për shembull shpenzimet për banim), nëse të njëjtat vlerësohet se janë në kufirin e "normales". Për Raportin sintetik të ekspertëve kombëtar të vitit 2009, "mungon një bazë e qartë për përcaktimin e të ardhurave minimale dhe papërshtatshmëri në shumatat e paguara për kategoritë e ndryshme në bazë të ndonjë shkaku logjik."

Në disa shtete anëtare, shumatat e të ardhurave minimale është fikse **lidhur me të ardhurat të cilat burojnë nga punësimi** (Danimarka, Luksemburgu, Malta dhe Holanda).

Në **Luksemburg**, të ardhurat minimale janë fikse me rrogën minimale dhe **pensionin minimal**, ndërsa në Maltë me **rrogën minimale**. Në Danimarkë, kjo është fikse me 80% të shtesës maksimale për papunësi për prindërit me fëmijë, dhe me 60% të këtij maksimumi për personat pa fëmijë.

Vetëm disa shtete anëtare e fiksojnë shumën në nivel të të ardhurave të garantuara lidhur me atë se cilat janë me të vërtetë nevojat e njerëzve ose ajo se çfarë është e mirë për pjesëmarrjen e tërësishme në shoqëri.

Në **Lituani**, minimumi i garantuar bazohet në çmimin e shportës blerëse, për të cilën ka pajtim. Në **Qipro**, bazohet në hulumtimin i cili bëhet duke shfrytëzuar tregues nga një hulumtim paraprak për buxhetin familjar. Në **Gjermani**, ndihma për



23. Idem 17.

24. Raporti i ekspertëve spanjoll për të ardhurat minimale në ueb-faqen e Network of Independent Experts, i disponueshëm në: www.peer-review-social-inclusion.eu/network-of-independent-experts/2009/minimum-income-schemes

shpenzimet jetësore (Hilfe zum Lebensunterhalt) përfshin ushqim, banim, veshje, higjienë personale, aparate për amvisëri, nxemje dhe nevoja për jetën e përditshme. Nevoja e përgjithshme për mjete për mbijetesë jepet në lloj të hapave standarde (Regelsätze) dhe tërësisht i përfshin shpenzimet për banim dhe ngrohje. Ekzistojnë edhe beneficione shpesh në raste të nevojave të posaçme.²⁵

Zakonisht, niveli varet nga **qëllimet politike të qeverisë**. Për shembull, nga ajo se sa duan qeveritë ta mbajnë nivelin e ulët për 't'i nxitur' njerëzit për të pranuar çfarë do qoftë pune.

Raporti sintetik i ekspertëve kombëtar i vitit 2009 gjithashtu përmend se një nga tendencat më të forta në shtetet anëtare është që të ndërlidhet dhënia e të ardhurave me përkrahjen për punësim dhe masat për aktivitet, si dhe se ekziston *"tendenca që në shumë shtete të rriten kushtet dhe të futen restriksione për qasjen në përfitime dhe shërbime sociale"*. Me të vërtetë, „Make Work Pay“ ishte një paradigmë në zhvillimin e politikave për punësim në vitet e fundit. Kjo tendencë çonte në këputje të beneficioneve sociale dhe atyre për punësim të cilat u jepeshin personave të papunësuar ose joaktiv, me qëllim që të intenzivohet nxitja për punë. Anëtarët e EAPN-ës vazhdimisht e potenconin ndikimin negativ të këtyre „Make Work Pay“ politika për të papunësuarit. Llogaritet se qeveritë përpiqen që t'i instrumentalizojnë beneficionet për t'i ngushtuar njerëzit deri në atë masë që ato të pranojnë çfarë do punë, me qëllim që ta rrisin përqindjen e të punësuarve dhe ta ulin numrin e njerëzve të cilët marrin beneficione. Në këtë kontekst politik, sanksionet ndaj beneficioneve shpesh përdoren kundër njerëzve. Për shembull, beneficionet mund të zvoglohen ose ndërpriten.

Si revidohen nivelet e të ardhurave minimale?

Qasjet kombëtare dallojnë shumë njëra nga tjetra.

Në një numër të madh të shteteve anëtare, shumica e minimaleve të garantuar revidohet çdo vit, në pajtim me grafikonin e çmimeve.²⁶

- **Vetëm në dy shtete përputhshmëria e nivelit të çmimeve është automatike** dhe nuk i është lënë në vendim të qeverisë (Belgjika dhe Luksemburgu).
- Në shtetet tjera, shumica është e ndërlidhur me nivelin e pensioneve ose rrogave.
- Në disa shtete anëtare, shumica është qartësisht e përshtatur me buxhetin ekzistues (Bullgaria, Latvia).
- Në Spanjë, freskimi i shumës bëhet me vendim nga ana e pushteteve regjionale. Në disa regjione, si Katalonia, kjo bëhet në marrëveshje me sindikatat.

25. Burim: ueb-faqja e MISSOC: Comparative table on social protection, e qasëshme në: http://ec.europa.eu/employment_social/missoc/db/public/compareTables.do

26. Idem.

Realiteti ashtu si e përjetojnë njerëzit në rrezik është se nivelet e të ardhurave minimale, të cilat edhe ashtu janë nën vijën e varfërisë, nuk i ndjekin rritjet e mëdha të çmimeve për nevojat bazike, siqë janë banimi, ushqimi dhe energjia elektrike në vitet e fundit, dhe me këtë zvoglohet edhe më shumë fuqia e tyre blerëse.

Në **Latvi**, qirajat janë rritur për 23,4% në periudhën mes kuartalit të fundit të 2007 dhe 2008, ndërsa çmimet e nxemjes për 31,6%²⁷ në vitin 2008. Çmimi i rrymës në shumë shtete është rritur me të vërtetë shumë (Itali, Belgjikë, Bullgari, Maltë etj.), dhe disa shtete përpiqen që ta kompenzojnë këtë barrë: për shembull, në Maltë, njerëzit më të varfër subvencionohen nga ana e qeverisë që të mund t'i paguajnë fakturat.

Edhe më i madh është presioni mbi të ardhurat minimale për shkak të krizës aktuale ekonomike.

Në krizën e tashme, dy tendenca të konfrontuara ndikojnë mbi të ardhurat minimale. Nga njëra anë, disa shtete anëtare ndërmarrin aksione për ta mirëmbajtur kohezionin social dhe për t'i mbrojtur më të prekshmit, duke përfshirë edhe rritjen e të ardhurave minimale dhe përfshirshmërisë. Nga ana tjetër, siqë është e ilustruar në raportin e EAPN-ës për pasojat sociale nga kriza,²⁸ ka një shtypje të ripërtirë për zvoglimin e skemave për të ardhurat minimale, kriteret e tyre të pranueshme ose përfshirjen e tyre²⁹ në kontekst të deficitit publik i cili është në rritje.

Belgjika e rriti përfshirjen e beneficioneve sociale për 2%. Mirëpo, qeveria nuk u pajtua që t'i rrisë të ardhurat minimale mbi pragun e varfërisë, siqë është kërkuar nga ana e shërbimeve sociale publike në nivel lokal (C.P.A.S.), së bashku me aktivitetet për luftë kundër varfërisë.

Romania e rriti nivelin e të ardhurave minimale për 15% nga korriku i vitit 2009, mirëpo kjo është ende larg asaj që është e nevojshme.

Bullgaria e rriti nivelin e të ardhurave minimale dhe të beneficioneve për familjet.

Anëtarët austriak të EAPN-ës e shprehën brengën e tyre lidhur me nivelin e beneficioneve, për shkak se beneficionet për papunësi janë në nivel të ulët dhe nuk janë të azhuruara.

Në **Spanjë**, anëtarët i theksojnë „dallimet e mëdha regjionale dhe zbatimin jo kosekuent, i cili i gërmon të ardhurat minimale si një e drejtë sociale, ku pushtetet lokale kanë një borxh prej 30.000 miliona eurosh dhe kërkojnë zvoglim.“ Në të njëjtën kohë, ato përmendin se qeveria spanjolle së vonti ka përcaktuar një beneficion fiks, dhe të punësuarit do të mund ta fitojnë vetëm nën disa kushte të caktuara, pasi që t'i kenë harxhuar të gjitha të drejtat e tyre për beneficione si persona të papunësuar.³⁰

Raporti për krizën e SPC/Komisionit thotë se “disa plane për mëkembje me qartësi e përcaktojnë shpenzimin e rritur në disa terriore që të jetë i balancuar me prerje në fusha të tjera ose se shpenzimet e përgjithshme do të jenë të zvogluara në tërësi (p.sh. IE)“.³¹

27. Burim: Updated assessment by the SPC and the European Commission of the Social impact of the economic crisis and the policy responses, maj 2009, të qasëshme në: <http://ec.europa.eu/social/keyDocuments.jsp?type=0&policyArea=750&subCategory=758&country=0&year=0&advSearchKey=&mode=advancedSubmit&langId=en>

28. Synthesis report on the social impact of the crisis, dhjetor 2009, e qasëshme në: http://www.eapn.eu/index.php?option=com_content&view=article&id=1294%3Aeapns-report-on-the-social-impact-of-the-crisis-and-of-the-recovery-package&catid=42%3Aeapn-policy-papers&Itemid=82&lang=en

29. Building Security, Giving Hope, EAPN assessment of the National Strategic Reports on Social Protection and Social Inclusion 2008-2010, e qasëshme në: http://www.eapn.eu/index.php?option=com_content&view=article&id=676:building-security-giving-hope-eapn-assessment-of-the-national-strategic-reports-on-social-protection-and-social-inclusion-2008-10&catid=42:eapn-policy-papers&Itemid=82&lang=en

30. Idem 27 u referohet të dhënave për të gjitha 5 shtetet

31. Idem 27.

Mosndërmarrja dhe mbrojtja e pamjaftueshme

Jo vetëm që shumat e të ardhurave minimale aktuale nuk janë të mjaftueshme, por edhe një pjesë e rëndësishme e popullatës nuk mundet me sukses t'ju qaset këtyre të ardhurave minimale të garantuara.

Nocioni i “mosndërmarrjes” zakonisht përdoret për ta përshkruar faktin se njerëzit nuk i kërkojnë beneficinet të cilat u takojnë. Mungesën e iniciativës për t'i ndërmarrë mund ta sqarojnë disa shkaqe:

- *Shumica e sistemeve për ndihmë sociale janë shumë komplekse, ndërsa njerëzit ose nuk janë mjaft të informuar ose nuk kanë përkrahje adekuate për t'i kërkuar beneficinet e tyre.*
- *Ende ka një stigmatizim të madh ndaj atyre të cilët marrin beneficione pa mos kontribuar, dhe njerëzit etiketohen si “lypsarë”. Prandaj edhe shumë njerëz nuk duan t'i kërkojnë këto beneficione.*
- *Në disa raste, siqë është rasti në Austri, mund të kërkohej kthim i ndihmës sociale atëherë kur përfituesi do të kthehet në punë.*

Një hulumtim³² i botuar nga OECD, në vitin 2004 tregon për atë se hapat e ndërmarrjes kryesisht ndryshojnë mes 40% dhe 80% në rastet e ndihmës sociale dhe programet për banim: kjo do të thotë se në çdo dhjetë njerëz të cilët kanë të drejtë që të marrin beneficione të tilla, prej **4 deri më 8 i realizojnë këto të drejta.**



Raporti sintetik i ekspertëve të pavarur për zbatimin e strategjisë për përfshirje sociale nga viti 2006³³ potencon se „në disa raste ndërlikueshmëria e sistemit paraqitet si një problem specifik për shkak se ndodh që kërkuarist adekuate të mos i fitojnë beneficinet që u takojnë, dhe të hekin dorë për shkak të ndërlikueshmërisë.”

Hipoteza për mosndërmarrjen në kohën e fundit kontestohet për shkak se koncentrohet vetëm në faktorë individual psikologjik, dhe njerëzit shpesh janë të penguar në kërkesën që bëjnë për të drejtat e tyre nga pengesa më të gjëra sociale dhe institucionale.

Një hulumtim i vitit 2004³⁴ nga I. Nikez dhe S. Hronez e përdor konceptin e “mbrojtjes së pamjaftueshme” për ta shënuar mospasësin e sistemit për të mundësuar të ardhura minimale universale. Me këtë hulumtim është konkluduar se “shkalla e mbrojtjes së pamjaftueshme ka qenë shumë e lartë në nivel vjetor, ku mes 2 dhe 13 përqind e popullatës

32. Take up of welfare benefits in OECD countries: A review of the evidence. OECD Social employment and Migration paper, e qasëshme në: www.oecd.org/dataoecd/60/30/30901173.pdf

33. Idem 17.

34. The big holes in the net, structural gaps in social protection systems and guaranteed minimum income systems in 13 EU countries, Ides Nicaise and Steven Groenez (HIVA, K.U. Leuven), April 2004. Shih listën e publikimeve nga Ides Nicaise në <https://perswww.kuleuven.be/~u0014508/hoofdpaginas/publistw.htm>

në një moment ka jetuar me më pak se të ardhurat minimale kombëtare (të garantuara)”. Hulumtimi ka qenë i bazuar në të dhënat nga viti 1993 deri më vitin 1997 në shtetet anëtare “të vjetra” të BE-së. Pa marrë parasyshë se të dhënat nuk janë nga më të rejtat, konkludimet janë në pajtim me atë që rregullisht e cekin anëtarët e EAPN-ës. Hulumtimi i cek shkaqet – përse skemat e të ardhurave minimale nuk kanë sukses të funksionojnë si një kufi absolut: rregullat për përshtatshmëri, pengesat administrative, gabime në kalkulimin e shumave, sanksione dhe suspendime, hyrja e tepërt në borxhe etj. Në disa raste skemat mund “të sigurojnë shuma më të ulta se ato të përcaktuara me ligj, kur dispozitat nuk zbatohen në tërësi ose kur një pjesë e beneficioneve ndalohen, si për shembull, kthyerja e borxheve.”

Në vitet e fundit, beneficionet ishin të instrumentalizuara me qëllim që njerëzve t’u bëhet presion për të pranuar vende të punës. Zbatoheshin sanksione mbi beneficionet. Analiza e bërë nga Mutual Information System on Social Protection Secretariat në 2008³⁵ e thekson ndikimin negativ të disa prej këtyre „Make Work Pay” politikave sa i takon, „qëllimit të skemave për të siguruar një nivel të përshtatshmë të të ardhurave për të gjithë”. Siqë tha një anëtar francez i EAPN-ës: „e drejta e të ardhurave minimale duhe të jetë e pakushtëzueshme për shkak se është minimalja për të mbijetuar. **Nuk mund të sanksionohen njerëz të cilët jetojnë me 440 euro në muaj!**”³⁶

Në raportin e vitit 2009, për shumicën e ekspertëve të pavarur kombëtar, “është e qartë se mosndërmarrja, edhe në rastet kur flasin për

mosndërmarrje jo të dokumentuar, është një problem i madh që ka nevojë për një shqyrtim të mençur” për shkak se ky problem i prek shumicën e shteteve.

Një hulumtim në Belgjikë, në periudhën 1993 deri më 1997, ka treguar se është shumë më i madh numri i individëve të cilët rrjeti i sigurisë nuk i ka shpëtuar (3.9%), se sa numri i atyre individëve të cilët i ka shpëtuar (1.2%).

Në Finlandë, në bazë të të dhënave të fituara nga viti 2005, është vlerësuar se vetëm gjysma e popullatës së përshtatshme ka marrë ndihmë sociale.

Eksperti austriak vëren se “shkalla e mosndërmarrjes tregohet për të qenë thelbësore”.

Për ekspertin gjerman “numri i vlerësuar i rasteve jo të paraqitura lëviz mes 25 dhe 40%”.

Në Portugali, shkalla e ndërmarrjes së skemës SSI lëviz prej 70 deri më 75%.

Fragmente nga Raporti sintetik i ekspertëve të pavarur kombëtar i vitit 2009³⁷

Ekspertët gjithashtu theksojnë se rreziku nga mosndërmarrja është më i madh tek disa grupe të caktuara. Për shembull, në Belgjikë, ky rrezik është më i madh tek gratë, çiftet, individët me arsim nën shkallën e dytë të shkollës së mesme dhe në moshë prej 16 deri më 24 vjeç. Në Austri, rreziku nga mosndërmarrja mund të dallojë shumë sipas regjioneve.



35. „Disa skema të përfitimeve të cilat mundësojnë mbrojtje minimale me anë të të ardhurave, i bëjnë përfituesit që të pranojnë çfarë do ofertë pune, pavarësisht se a është adekuate ose jo, dhe ajo që është më e keqe u ndërpiten përfitimet kur ato i refuzojnë këto punë. Eksperiencia tregon se kjo mund të krijojë një situatë ku një pjesë e madhe e atyre të cilët targetohen me këto skema të mos mund të përfitojnë nga ato, qoftë për shkak të asaj se nuk mund t’i marrin përfitimet nëse nuk pranojnë që të punojnë ose qoftë për shkak të asaj se të ardhurat e dhëna janë të pamjaftueshme për të marrë krejtësisht pjesë në shoqëri për shkak të sanksioneve me të cilat zvoglohet niveli i përfitimit për një periudhë të caktuar kohore”. In Missoc analysis 2008: social protection, aspect of flexi-curity and active inclusion, e qasëshme në: <http://ec.europa.eu/employmentsocial/missoc/2008/missoc2008a-nalysisen.pdf>

36. Idem 28.

37. Види: <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=756&langId=en>

LLOGARITJA E PËRSHTATSHMËRISË

Idea për realizimin e të ardhurave minimale të përshtatshme për të gjithë, shpesh has në një skepticizëm të madh. Njerëzit nuk besojnë se është e mundur që të llogaritet dhe të gjendet pajtueshmëri për atë se çfarë me të vërtetë është e nevojshme për një jetë të denjshme, në veçanti në nivel të BE-së, në shtete e ndryshme anëtare.

Në nivel të BE-së nuk ka metodë me të cilën do të mund të matet se cili nivel i të ardhurave është i nevojshëm për një jetë të denjshme. Duke e marrë parasyshë paaftësinë e sistemit aktual për mbrojtje sociale për t'u përgjigjur ndaj mbijetesës së varfërisë, hulumtuesit, aktivistët, vetë njerëzit të cilët jetojnë në varfëri dhe disa departamente të administratës publike, hulumtojnë metoda të ndryshme për kalkulimin e përshtatshmërisë, si dhe për instrumentet e domosdoshme në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së. Ato përpiqen që të përcaktojnë se çfarë në kornizat reale do të thotë një standard i denjshëm për jetesë, duke i marrë parasyshë nevojat bazike në shoqërinë tonë dhe sa kushtojnë ato.

Më poshtë janë të prezantuara disa qasje të cilat nxisin të menduarit dhe të njejtat i paraqesin përparësitë dhe mangësitë e tyre.

3.1. Tregues të vobegësisë materiale: një qasje statistikore e BE-së për stilin joadekuat jetësor

Përmbledhja aktuale e treguesve të BE-së [për të cilat ekziston rreziku, si pjesë e Metodës së Hapur të Koordinimit](#)³⁸ (OMC) në lidhje me përfshirjen dhe mbrojtjen sociale (të ashtu quajturit „Laeken“ tregues), nuk mundëson një kuptim ose krahasim të vërtetë të situatave konkrete të personave të cilët jetojnë në varfëri. Në vitin 2007, një grup ekspertësh për politika sociale bënë thirrje për ta hulumtuar të ardhmen:

- *„çfarë me të vërtetë mund të konsumojë një familje në çdo shtet veçmas, e cila familje jeton me 60% nga pragu u varfërisë?“*
- *„si është relacioni në çdo shtet mes pragut prej 60% dhe të ardhurat minimale? Dhe deri në cilën masë njerëzit të cilët bien nën vijën e varfërisë me të vërtetë gjenden në vijën e të ardhurave minimale të garantuara?“*³⁹

Në vitin 2009, është bërë edhe përmirësimi i parë në përmbledhjen e treguesve: janë përputhur dy tregues të ri për ta plotësuar përmbledhjen e treguesve të shfrytëzuar nga OMC-ja sociale, që kanë për qëllim mbikqyrjen e **vobegësisë materiale**. Edhe pse këto tregues nuk janë në mënyrë specifike të dizajnuar për të ndihmuar gjatë llogaritjes së nivelit të përshtatshmërisë së të ardhurave minimale, në realitet do të ndihmojnë për:

38.B. Nolan, with E. Marlier, A.B. Atkinson and B. Cantillon (2006) The EU and Social Inclusion: Facing the Challenges. Bristol: Policy Press.

39. Burim i të dhënave: anketa e EU-SILC është vjetore, në të gjithë BE-në, si pjesë e programit të BE-së për fitimin e informatave për të ardhurat dhe kushtet jetësore në lloje të ndryshme të amvisërive.

- *njëkuptim më të qartë për atë se çfarë konkretisht do të thonë të ardhurat e papërshtatshme, duke marrë parasysh llojllojshmërinë e kushteve jetësore në shumicën e shteteve anëtare;*
- *fokus tek grupet më të prekshme të njerëzve të cilët jetojnë nën vijën e varfërisë. Me të vërtetë, mes njerëzve të cilët janë në rrezik nga varfëria, disa jetojnë nën këtë vijë: këto tregues të rinj e shënojnë përqindjen e njerëzve të cilët jetojnë në vobegësi ekstreme.*

Vlerësim i asaj që llogaritet për të qenë e domosdoshme për një jetë normale dhe të denjshme

Këto tregues të ri të vobegësisë materiale e vlerësojnë qasjen në të mirat dhe shërbimet bazike, të cilat llogariten si të domosdoshme për një jetë normale dhe të denjshme.

Ato bazohen në një listë prej 9 gjërave⁴⁰ të cilat socialisht identifikohen si të domosdoshme (shih tabelën më poshtë):

Lista e gjërave të cilat janë identifikuar si të domosdoshme:

Amisëria mund t'i lejojë vetes:

- të paguaj borxhe (hipotekë ose qira, fatura ose pagesë e vonuar me rata);
- një javë pushim larg shtëpisë;
- të ketë ngrohje adekuate në banesë;
- ushqim me mish, mish pule ose peshk çdo të dytën ditë;
- të ballafaqohet me shpenzime jo të parapara.

Amvisëria mund t'i lejojë vetes (kur të dojë):

- të ketë TV;
- të ketë telefon;
- të ketë automobil;
- të ketë makinë për larjen e teshave.

Përzgjedhja e këtyre gjërave u vërtetua në mënyrë sociale nëpër BE me hulumtin Eurobarometër, i cili dëshmoi se gati secila prej këtyre gjërave llogaritet si domosdoshmëri absolute ose domosdoshmëri për të pasur një standard jetësor adekuat, nga më pak se 50% e popullatës në BE 27. Njerëzit të cilët ballafaqohen me varfërinë, së bashku me EAPN, gjithashtu u përfshinë në testimin e këtyre prioritetëve.

Dy tregues të ri

Treguesi i parë i pranuar është **përqindja e njerëzve të cilëve u mungojnë së paku 3 gjëra nga lista**. Në vitin 2006, 3% të popullatës në Luksemburg i kanë munguar së paku 3 gjëra nga lista, ndërsa në Latvi, 50% të popullatës i kanë munguar së paku 3 gjëra kjo listë.

Treguesi i dytë i pranuar është **numri mesatar (gjegjësisht mesatarja) e gjërave të cilat u kanë munguar personave të rrezikuar në shtete të ndryshme**. Ai duhet t'i përgjigjet pyetjes së ardhshme: në grupin e njerëzve të cilëve u mungojnë së paku 3 gjëra, sa gjëra mesatarisht u mungojnë njerëzve, 3, 4 ose më shumë? Deri në cilën masë u mungojnë të mirat bazike? Si të vlerësohet vështirësia e vobegësisë së tyre?

Për shembull, në Islandë, njerëzve të cilëve u mungojnë së paku 3 gjëra, mesatarisht u mungojnë 3,36 gjëra, ndërsa në Latvi në grupin e njerëzve të cilëve u mungojnë së paku 3 gjëra, mesatarja e gjërave të cilat u mungojnë është 4,12. Kjo do të thotë se vobegësia e personave të prekshëm është më e vështirë në Latvi se sa në Islandë.

Tabela më poshtë i paraqet vlerat e shkallës së vobegësisë në BE, si dhe indeksin e mesatares së vobegësisë në BE.

40. Idem 39.

Shteti	% e njerëzve të cilëve u mungojnë së paku 3 gjëra	Mesatarja e gjërave mes të 'deprivuarve'
Luksemburgu (LU)	3	3,49
Norvegjia (NO)	5	3,71
Suedia (SE)	6	3,45
Holanda (NL)	6	3,48
Islanda (IS)	8	3,36
Danimarka (DK)	8	3,59
Finlanda (FI)	10	3,48
Austria (AT)	10	3,48
Mbretëria e Bashkuar (UK)	10	3,49
Spanja (ES)	11	3,45
Irlanda (IE)	11	3,66
Franca (FR)	13	3,57
Belgjika (BE)	13	3,76
Gjermania (DE)	13	3,51
Italia (IT)	14	3,70
Sllovenia (SI)	14	3,49
Republika e Çekisë (CZ)	20	3,79
Portugalia (PT)	20	3,74
Greqia (GR)	23	3,81
Qiproja (CY)	31	3,50
Sllovakia (SK)	36	3,77
Hungaria (HU)	38	3,96
Lituanian (LT)	41	4,09
Polonia (PL)	44	4,06
Latvia (LV)	50	4,12

Shkalla e vobegësisë (prej 9 gjërave) mes njerëzve të cilëve u mungojnë së paku 3 gjëra nga lista, 2006. Burim: Eurostat, EU-SILC 2006.

Përparësitë dhe mangësitë e qasjes

Përparësitë

Treguesit për vobegësinë materiale japin një pikturë më të qartë për njerëzit të cilët jetojnë nën vijën e varfërisë të caktuar në BE.

Përzgjedhja e treguesve është vërtetuar me opinionin në BE: që është një hap i rëndësishëm kah standardet sociale në nivel të BE-së.

Pajtueshmëria për treguesit e paraqet konsenzusin e rëndësishëm mes institucioneve dhe shteteve anëtare në nivel të BE-së lidhur me përmbledhjen e gjërave të cilat llogariten si të domosdoshme për të bërë një jetë të denjshme.

Këto tregues e plotësojnë vijën e 60% të ardhura mesatare dhe me këtë e mirëmbajnë këtë pikë të rëndësishme referente.

Mangësitë

Njerëzit e prekur nga varfëria nuk ishën në mënyrë sistematike të përfshirë në formimin e këtyre treguesve, edhe pse ishën të përfshirë në testim. Kjo mund të ketë krijuar ç'rregullimin e prioritetëve.

Nëntë gjërat janë selektuar nga shumica e popullatës së BE-së në hulumtim, mirëpo shumë njerëz nuk u kanë dhënë prioritet gjërave të njejta.

Treguesit nuk e paraqesin në tërësi shumëdimensionalitetin e varfërisë (në aspekt të qasjes në një banesë të denjshme, jetë shoqërore, kulturë, arsim, shëndetësi etj.), as po e paraqesin veprimin e ndërmjetshëm në mes të faktorëve.

Ato nuk e paraqesin realitetin e ashpër të varfërisë në disa shtete. *“Në Romani, njerëzve të cilët jetojnë në varfëri, së pari ju duhen mjaft mjete për të mbijetuar, pastaj për t'i dërguar fëmijët në shkollë,*

për shkak se të gjitha shkollat janë të shtrenjta (më tepër se 50 euro në muaj për një njeri). Shumica e njerëzve të varfër nuk kanë shtëpi për të jetuar e cila ka kushte bazike sanitare”, raportoi një anëtar i BE-së.

Treguesit janë shfrytëzuar në atë mënyrë që koncentrohen vetëm në format **absolute të varfërisë**, në dëm të politikave më ambicioze kundër varfërisë, të orientuara kah ulja e varfërisë relative dhe promovimin e një shoqërie më të drejtë.

Në përgjithësi, është e nevojshme një qasje më ambicioze për ta përmirësuar kapacitetin e BE-së për ta kuptuar dhe trajtuar realitetin konkret të njerëzve të cilët jetojnë në varfëri. Në veçanti, është i nevojshëm një hulumtim më i përpiktë për fuqinë blerëse konkrete të njerëzve të cilët jetojnë nga skemat e të ardhurave minimale.

3.2. Buxheti i standardit minimal për një jetë të denjshme në Britani

Projekti i Joseph Rowntree Foundation për standardin e të ardhurave minimale tregon se është e mundshme që të përcaktohet se cili nivel i të ardhurave mundëson jetë të përshtatshme.

Hulumtimi i botuar më 1 korrik të vitit 2008 nga ana e fondacionit Joseph Rowntree është i orientuar për t'i dhënë përgjigje pyetjes: cilin nivel të të ardhurave njerëzit e llogarisin të nevojshëm për të mundur një standard të pranueshëm shoqëror të jetesës dhe pjesëmarrje në shoqërinë në Britani sot?

Hulumtimi ka shpikur një standard të të ardhurave minimale për Britaninë, bazuar në atë se çfarë thonë pjesëtarët e opinionit publik dhe i ka prezantuar shpenzimet për mbulimin e të mirave bazike dhe shërbimeve për llojet e ndryshme të amvisërive. Raporti i tërësishëm mund të gjendet në ueb-faqen e projektit:

www.minimumincomestandard.org

Ka pësuar një kombinim i dy **metodologjive për standard buxhetar**, të shfrytëzuara paraprakisht: **metodologjia konsensuale** e bazuar në diskutimet publike mes pjesëtarëve të opinionit dhe **metodologjia e udhëhequr nga ekspertët**. Hulumtimi e sheh standardin minimal për jetesë për të qenë më shumë se sa siguri i ushqimit, veshjes dhe strehimit, si përgjigje për atë se çfarë është e domosdoshme për të fituar mundësi dhe zgjidhje për të marrë pjesë në shoqëri.

Listat për atë se çfarë është e nevojshme për amvisëritë e ndryshme janë bërë gjatë

36 **diskusioneve grupore** dhe punëtorive. Kjo përfshin: ushqim, veshje, banim, fatura, karburantë, aparate për amvisëri, të mira dhe shërbime personale, transport, aktivitete shoqërore dhe kulturore. Grupet janë informuar me anë të këshillave të specialistëve (siqë janë nutricionistët, inxhinjerë për nxemje etj.). Pjesëmarrësit gjithashtu janë koncentruar mbi nevojat, dhe jo mbi dëshirat.

Si rezultat, hulumtimi jep **buxhet javor për lloje të ndryshme të familjeve, i cili do të mundësojë një standard jetese të pranueshëm nga ana e "burrit dhe gruas së rëndomtë".**

Projekti konkludon se **në Britani, shteti nuk arrin t'u garantojë njerëzve mjete të mjaftueshme për të fituar atë të cilat këto grupe e kanë llogaritur si nivel të pranueshëm**. Sipas këtij hulumtimi, **përkrahja në të ardhura përfshin vetëm 42% nga ky buxhet i pranueshëm** në rastin e një personi të vetëm për vitin 2008. Familjet me fëmijë, të cilat jetojnë nga të ardhurat sociale, marrin rreth 2/3 nga ky buxhet i pranueshëm. Të ardhurat sociale për një çift (pensionerë) e tejkalojnë këtë buxhet për 5%.

Ky hulumtim është azhuruar në korrik të vitit 2009. Tregon se shpenzimet e buxhetit minimal në amvisëri janë rritur për 5%. *"Kjo është shumë më lart shkallës së inflacionit për shkak se dikush i cili jeton me të ardhura minimale harxhon më tepër se gjysmën e buxhetit për ushqim, karburantë shtëpiak dhe transport publik, çmimet e të cilit janë rritur prej 7 deri më 12 përqind"*, thonë ato.

Interesant është ajo që hulumtimi sqarues tregon se edhe në kohën e recesionit, njerëzit ende mendojnë se standardi minimal për jetesë duhet t'u mundësojë njerëzve jo vetëm mbijetesë, por edhe pjesëmarrje aktive në shoqëri.

Përparësitë dhe mangësitë e qasjes

Përparësitë

Qasja në mënyrë efikase e vlerëson shkallën e përshtatshmërisë së beneficioneve të rrjetit sigurues, duke e treguar mundësinë nga arritja e konsenzusit për të mirat e domosdoshme për një jetë të denjshme.

Për shkak se rezultatet janë krijuar sipas mendimit të njeriut të “rëndomtë”, gjasat janë më të mëdha se ato do ta lehtësojnë konsenzusin për nivelin e beneficioneve të pranueshme.

Qasja është e rëndësishme për shkak të gjithëpërfshirshmërisë së saj, sepse e njejta mund të zbatohet në situata të shumta.

Pjesëmarrjes i është dhënë përparësi. Njerëzit të cilët jetojnë në varfëri janë të përfshirë në vendim-marrjen për treguesit, dhe jo vetëm në kontrollimin e tyre.

Përfshirja e grupeve të përziera të përfituesve siguron një vlerësim më të drejtë të standardeve të nevojshme për një jetë të denjshme, për shembull: grupi i prindërve të vetëm përfshin prindër të vetëm më të varfër dhe më të pasur. Përfshirja e njerëzve vetëm të varfër sjell rrezikun nga krijimi i niveleve edhe më të ulta të minimale.

U dëshmuua si një mjet i dobishëm për iniciimin e diskutimeve, si dhe për lobimin dhe krijimin e politikave.

Qasja mundet shumë lehtë të freskohet, gjegjësisht, të vlerësohet ndikimi i krizës aktuale ndaj më të varfërve. Për shkak se është një hulumtim me pjesëmarrje, flitet edhe për mendimin e opinionit publik për standardet minimale të jetesës, duke potencuar se edhe në kohëra të krizës ekonomike, banorët e MB nuk hekin dorë nga ambicja për të siguruar një standard minimal, të denjshëm për të gjithë.

Mangësitë

Mendimet e grupeve të ndryshme përfituese dhe synuese janë marrë parasyshtë gjatë përcaktimit të asaj se çfarë është e pranueshme për “të gjithë”. Mirëpo, nuk ka një fokus specifik mbi mendimet dhe profesionalizmin e njerëzve të cilët jetojnë në varfëri, ndërsa zëri i tyre duhet të jetë në thellimin e cilit do diskusioni për përshtatshmërinë.

Qasja është shumë intenzive dhe e ndërlikuar, dhe ka nevojë për shumë kohë, personel dhe mjete. Kjo e bën atë të vështirë për t’u organizuar.

Mirëpo, shtetet tjera mund vetëm të ndërlidhen në punën që është bërë.

Qasja kërkon një ndjekje intenzive për t’u siguruar se buxheti i propozuar javor do të mirëmbahet. Gjithashtu, është e vështirë që të ndiqen ndryshimet e standardit jetësor në afat më të gjatë kohor, gjë e cila mund të ketë nevojë për rishikim të përmbytjes së buxhetit minimal.

Qasja nuk e mirëmban lidhjen me referencën e 60% të vijës mesatare: kjo sjell rrezik për shkak se diskusioni mund më tepër të bëhet për varfërinë materiale, se sa për varfërinë relative dhe pabarazinë.

3.3. Model i shportës së shpenzimeve i bazuar në eksperiencat e njerëzve të cilët jetojnë në varfëri

Projekti transnacional i BE-së, i udhëhequr nga EAPN në Irlandë, me titullin “Caktimi i standardeve minimale sociale në tërë Evropën”, gjatë dy viteve (2005-2007) grumbulloi mendime të ndryshme publike dhe joqeveritare për çështjen e rolit të BE-së, gjegjësisht çfarë mund të bëjë ajo gjatë përcaktimit të standardeve sociale të cilat do ta përforcojnë luftën kundër varfërisë. Raporti i fundit⁴¹ i prezanton elementet e konsenzusit të arritur mes pjesëmarrësve. Ai pohon se “pajtueshmëria për një qasje të përbashkët në standardet sociale në nivel të BE-së është më mirë për t’u parë si një proces i dialogut i cili e përfshin Bashkimin Evropian, Shtetet Anëtare, njerëzit të cilët përjetojnë varfëri, hulumtuesit social dhe opinionin e përgjithshëm, për t’u pajtuar për një grup të të mirave dhe shërbimeve të nevojshme në çdo shtet anëtar për një jetë të denjshme, si dhe programe dhe veprime shtesë në të gjitha nivelet adekuate, për të mundësuar që secili të ketë qasje në ato ‘gjëra’”.

Rrjeti Belgjik Kundër Varfërisë, pasi që u përfshi në këtë projekt transnacional, tani është i angazhuar në një projekt hulumtues në nivel kombëtar për “një metodologji të praktikës së mirë për ta vlerësuar përshtatshmërinë”, i cili zbatohet nga Universiteti në Antwerpen dhe Shkolla e Mesme Katolike nga Kempteni, gjë e cila mund të shihet si një vazhdim i projektit për standardin social.

Faza e parë u zbatua në regjionin flaman. Rrjeti Regjional Flaman Kundër Varfërisë morri pjesë

në grupin udhëheqës të hulumtimit, ndërsa disa shoqata të qytetarëve të cilët jetojnë në varfëri u përfshinë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në fokus grupe.

Në kuadër të këtij projekti, hipotezat shkencore për nevojat njerëzore për një jetë të denjshme u testuan kundrejt eksperiencave të njerëzve të cilët jetojnë në varfëri. Projekti shfrytëzoi “shportën e të mirave” akademike e cila ishte gjithëpërfshirëse dhe precize në numërimin e asaj që është e nevojshme për një jetë të denjshme, duke filluar nga nevoja për ushqim, dhe deri tek pjesëmarrja në aktivitetet kulturore, banim, siguri etj. Për secilën prej këtyre gjërave, projekti së pari ka filluar duke grumbulluar pikëpamje shkencore nga specialistë profesionalë në këtë temë. Pastaj rezultatet janë kontrolluar nga pikëpamja dhe eksperiencat e fokus grupeve, përmes punonjësve social të cilët kanë punuar në këtë rreth dhe përmes një njeriu i cili ka jetuar në varfëri. Kësaj të fundit i kushtohet kujdes i posaçëm, në rastet kur kemi rezultate të njëjta në të dy fokus grupet.

Nevojat kanë qenë të planifikuara për lloje të ndryshme të amvisërive, ndërsa pastaj është diskutuar e njëjta përsëri në grupe duke përfshirë specialistë dhe njerëz të cilët kanë jetuar në varfëri nga disa shoqata.

Informatë kthyesë nga njerëzit të cilët jetojnë në varfëri është shfrytëzuar për t’u theksuar momenti kur modeli akademik nuk i është përgjigjur realitetit të jetesës në varfëri dhe për t’u propozuar ndryshime. Për shembull:

- Disa njerëz jetojnë larg shitoreve me çmime më të ulta, kështu që duhet të zgjedhin mes blerjes së të mirave me çmim më të lartë në shitoren më të afërt ose të paguajn transport për të arritur tek shitorja me çmime më të lira.



41. www.eapn.ie/standards

- Disa njerëz nuk kanë frigorifer ose frigorfier me ngrirje të thellë. Kjo do të thotë se duhet ta planifikojnë blerjen prej ditës në ditë, se sa t'i zvoglojnë shpenzimet me atë që të gjitha do t'i blejnë përnjëherë.
- Modeli nuk i mbulon nevojat specifike të ndërlidhura me ndonjë sëmundje ose shëndet të ç'rregulluar, ndërsa njerëzit të cilët jetojnë në varfëri u janë të prirë sëmundjeve, duke përfshirë edhe problemet mentale.

Në fazën e dytë e cila është dashtur që të zgjasë deri në fund të vitit 2009, metoda ka qenë e zbatuar në dy regjionet tjera të vendit, Valoni dhe Bruksel. Pritet që rezultati të zbulojë një mjet më të përgjithshëm i cili mund të zbatohet në të gjithë vendin (në këtë fazë më të gjërë të hulumtimit, shpenzimet për shëndetësi do të marrin parasyshë me më seriozitet).

Përparësitë dhe mangësitë e qasjes

Përparësitë

Rezultati i parë dëshmoi se buxheti i cili është i nevojshëm për një jetë të denjshme është më i lartë se vija kombëtare e varfërisë, por më i lartë edhe se niveli i të ardhurave minimale.

Rezultati e potencon rolin kyç të pjesëmarrjes së njerëzve të prekur nga varfëria.

Buxheti është i orientuar kah pjesëmarrja e tërësishme në shoqëri, dhe jo vetëm kah minimumi

për të mbijetuar. I merr parasyshë rolet e njeriut në shoqëri dhe pritjet. Për shembull, si prindër prej jush pritet që të kujdeseni për fëmijën tuaj dhe t'i mundësoni arsim të mirë; si punëtor pritet që të kontribuoni në prodhimin e të mirave dhe shërbimeve, duke mbajtur hap me arritjet e reja në sektorin tuaj, si dhe zbatimin e detyrave të punës; si anëtarë i bashkësisë suaj lokale duhet të jenë të informuar për atë se çfarë ndodh rreth jush etj.

Mangësitë

Modeli shkencor i buxhetit i referohet një personi fiktiv "ideal", për të cilin supozohet se është i shëndetshëm, pa nevoja specifike të cilat kërkojnë shpenzime shtesë (psh: invaliditet), shumë mirë i informuar dhe vepron në mënyrë racionale kur blen. Realiteti i personave në varfëri është shumë më ndryshe.

Projekti kufizohet në konfrontimet mes ekspertizave akademike, opinioneve të punonjësve dhe eksperiencave të të varfërve, ndërsa nuk i përfshin mendimet e personave "të rëndomtë"; ky model buxheti nuk është i testuar në aspekt të standardeve kryesore për jetesë, që duhet dhe të jetë referenca kryesore për definimin e një jete të denjshme (për

shembull: modeli shkencor i buxhetit i përdorur përfshin një sasi të mishit të mjaftueshme nga pikëpamja e shëndetit, mirëpo i klasës më të ulët sa u takon standardeve të konsumimit).

Hulumtimi nuk e merr parasyshë gjendjen e migrantëve në vend. Disa rezultate me migrantët treguan shumë ngjashmëri me njerëzit nga regjioni flaman të cilët jetojnë në varfëri, mirëpo edhe disa probleme të rëndësishme shtesë. Këto nuk janë të integruara në rezultatet finale të fazës së parë, dhe nuk janë marrë parasyshë as në fazën e dytë (Në Valoni dhe Bruksel).

Kjo qasje nuk ndërlidhet me vijën mesatare referencë prej 60% dhe kjo sjell rrezikun që të bëhet një diskutim i fokusuar në varfërinë materiale absolute dhe jo në varfërinë relative dhe pabarazitë.

3.4. Shfrytëzimi i buxhetit referent si standard gjatë krijimit të politikave: modeli i Suedisë

Buxhetet referente janë modele të shpenzimeve për lloje të ndryshme të amvisërive. Buxhete të tilla janë krijuar në tërë Evropën dhe janë përdorur për qëllime të ndryshme. Ekziston një projekt evropian i përkrahur nga Komisioni Evropian nën Programin për Progres, i koordinuar nga disa anëtare të European Consumer Debt Network. Aktualisht promovon krijimin e buxheteve të tilla në shtetet në të cilat deri tani nuk janë shfrytëzuar dhe e zmadhon shkëmbimin mes grupeve në shtetet të cilat kanë shfrytëzuar buxhet të tillë me vite.⁴²

Materiali i marrë nga ky projekt sjell shembuj interesant nga vende të ndryshme. Në Suedi, buxheti referent është më tepër se një buxhet i minimale. Është krijuar që nga viti 1976. Ai lejon që të përbushen shumica e nevojave bazike si për shembull, mundëson që njerëzit të marrin pjesë në jetën shoqërore duke përfshirë këtu edhe aktivitetet rekreative. Shumat dhe mënyrat e llogaritjes janë publike. Ky buxhet referent ose buxhetet e ngjajshme referente shfrytëzohen për:

- *Këshillim buxhetar dhe lehtësim borxhi;*
- *Shqyrtim kreditor atëherë kur bankat japin hua;*
- *Pagesë të borxheve;*
- *Hulumtim publik lidhur me buxhetin e amvisërisë;*
- *Analizë të gjendjes në grupet e ndryshme të amvisërive;*
- *Arsim;*
- *Rritje të vetëdijes.*

Në moment përdoret edhe si pikë referente për ndihmën sociale.

Për shembull, për familjet me dy persona të rritur, një djalë 10 vjeç dhe një vajzë 4 vjeçe, shpenzimet ditore sipas buxhetit referent të Suedisë i përfshijnë gjërat e ardhshme: ushqim, veshje, këpucë, higjienë, rekreim, material harxhues, gazeta, radio, TV, telefon, dhe atë për një shumë prej 825 euro në muaj. Shtesa sociale do t'u shtohet të ardhurave për harxhimet të kësaj familje në një shumë të buxhetit referent, plus shpenzimet reale siqë janë banimi, rryma elektrike, udhëtimet deri në dhe prej punë, sigurimi i amvisërisë, kujdesi për fëmijët dhe anëtarësim në sindikatat dhe në fondin për sigurim në rast papunësie, nëse mendohet se janë të arsyeshme.

Përparësitë dhe mangësitë e qasjes

Përparësitë

Buxheti referent është një mjet objektiv dhe efikas për llogaritjen e shtesave sociale.

Fakti se ky buxhet referent është në mënyrë objektive i shfrytëzuar si një referencë publike për shtesën sociale i jep legjitimitet këtij mjeti dhe

është një hap përpara kah njohja e të drejtës për një jetë të denjshme.

Ky buxhet referent është shfrytëzuar në shumë mënyra, të cilat këtij mjeti i japin qartësi me të cilën mund të kontribuohet për kuptimin më të mirë të realitetit të varfërisë. Niveli i lartë i transparencës krijon pranueshmëri dhe legjitimitet.

Mangësitë

Buxheti referent nuk i mbulon shpenzimet e tërësishme ditore të familjes, më saktësisht qiranë dhe energjinë elektrike. Këto shpenzime mund të mbulohen, mirëpo nuk shqyrtohen veçmas. Në praktikë, komunat mund të krijojnë udhëzime lokale për këto punë si për shembull, kufirin deri në të cilin do të mbulohet shuma për harxhimet e banimit.

Ky buxhet referent në të njejtën kohë është bërë edhe maksimumi edhe minimumi. Përpara se të krijohet disa komuna ishën më zemërgjëra. Është i shkëputur nga vija mesatare referente prej 60%.

Nuk ka pjesëmarrje specifike të njerëzve të cilët e përfetojnë varfërinë.

Shpenzimet e ndryshme nuk janë në mënyrë adekuate të azhuruara, gjegjësisht lidhur me shpenzimet rritëse për shëndetësi, energji, banim dhe energjensia.

Niveli nuk është mjaft zemërgjërë për të siguruar pjesëmarrjen e plotë në shoqërinë e sotshme. Gjendja e personave të prekshme është bërë edhe më e vështirë nga presioni aktual për t'i zvogluar programet dhe përkrahjen sociale.

AVANCIMI NË KRIJIMIN E POLITIKAVE: SHEMBULLI I SHTYLLËS SË PENSIONIT

Përshtatshmëria është nocioni qendror në debatin politik të BE-së lidhur me pensionet.

Në nivel të BE-së, me Metodën e Hapur të Koordinimit (OMC) [ër mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale janë zbatuar Strategjia për oensione paralelisht me Strategjinë për përfshirje sociale dhe me Strategjinë për shëndetësi dhe kujdes afat-gjatë.

Strategjia për pensionet e BE-së është organizuar rreth qëllimeve të **përshtatshmërisë** së dispozitave pensionale dhe **qëndrueshmërisë financiare** të sistemit pensional. Strategjia është e orientuar për t'ju përgjigjur kërtimeve për ardhmërinë e pensioneve të cilat paraqiten për shkak të evolucionit demografik, dhe ngga rrezi-ku i lartë të varfërisë mes personave të moshuar në shumë shtete anëtare (për më tepër informata shih ueb-faqen e Komisionit Evropian⁴³, dedikuar kësaj çështjeje).

Edhe pse aspekti i qëndrueshmërisë ka tendencë që të jetë dominant në programin aktual nacional për pensionet, organizatat të cilat i përfaqësojnë interesat e më pleqëve insistojnë që përshtatshmëria e të ardhurave të pleqëve të mbetet qëllimi fundamental i cilit do modeli pensional (informata në detaje për këtë diskutim mund të gjenden

në ueb-faqen e AGE⁴⁴, Platforma Evropiane e Personave më të Moshuar⁴⁵). Veç kësaj, në kontekst të krizës, organizatat për personat e moshuar e shfrytëzojnë mundësinë për të kujtuar për rolin e shtetit në sigurimin e pensioneve primare për të gjithë, ku kontributet individuale janë plotësuar me një komponentë efikase të solidaritetit.

Në këtë aspekte, platforma AGE në deklaratën e saj për pensionet në vitin 2009, Sigurimi i pensioneve të përshtatshme për të gjithë në BE – përgjegjësi e ndarë për shoqërinë, më urgjencë të re e përsërit thirrjen e tyre për:

- *Pensione të balancuar dhe të llojllojshme me skema ligjore të përshtatshme dhe të sigurta (gjegjësisht shtylla e parë);*
- *Siguri e përforcuar për të drejtat individuale në skemat e pensioneve të financuara;*

43. <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=752&langId=en>

44. www.age-platform.org

45. E qaswshme nw: <http://www.age-platform.eu/en/age-policy-work/social-protection/age-position-statements>



- Masa për lehtësim gjatë mbajtjes së punëtorëve më të moshuar në vendet e tyre të punës dhe qasje në punë kualitative për ato të cilët kërkojnë punë;
- Të kushtohet kujdes i posaçëm me qëllim që të përgjigjet ne pabarazitë ekzistuese në bazë të gjinisë në të ardhurat moshore dhe të evitohet krijimi i burimeve të reja të pabarazive për grupet e ardhshme;
- Përkrahje e individëve me karrierë pune më të shkurtër ose jotipike për 'ju ndihmuar në krijimin e të drejtave të mjaftueshme për pension.

Platforma AGE insiston në nevojën për sigurim, gjegjësisht cila do qoftë reformë pensionale kur krijon lidhje mes kontributeve dhe beneficioneve do të miratohet në mënyrë adekuate dhe socialisht të drejtë.

Në BE është veçanërisht e rëndësishme të theksohen kërkesat e lartpërmendura lishur me përshtatshmërinë ku njerëzit mbi 65 vjeç shpesh janë në rrezik më të madh nga varfëria



krahasuar me grupet e tjera të popullatës.⁴⁶ Sipas Platformës, kjo do të thotë rekomandime specifike në aspekt të vendimeve politike të orientuara kah grupet më të prekshme të personave të moshuar, siqë janë gratë më të moshuara, të vetmuarit, migrantët ose personat me invaliditet:

- Shtetet anëtare duhet të garantojnë të ardhura minimale për personat e moshuar, të cilat do të jenë ekuivalente së paku me pragun e varfërisë prej 60% të të ardhurave nacionale mesatare në amvisëri, si një mënyrë për ta avancuar përfshirjen dhe autonominë e tyre sociale.
- Të shqyrtohet neni 1 nga Karta Evropiane për të Drejtat Themelore lidhur me dinjitetin njerëzor gjatë krijimit të skemave pensionale, gjegjësisht e drejta e përshtatshmërisë së të ardhurave minimale duhet të merret si bazike dhe e domosdoshme për dinjitetin dhe pavarësinë e secilit.
- Kontributi i atyre të cilët janë të papunësuar, të sëmurë ose kujdesen për fëmijët dhe më të moshuarit kur nxiten dhe imponohen skema financiare private.
- Zhvillimi i një mekanizmi i cili do të jetë rrjet gjithëpërfshirës sigurie, i cili do t'ju mundësojë më të moshuarve një jetë të denjshme.
- Të sigurohet një përputhshmëri e përshtatshme e pensioneve që ato të jenë në rrjedha me avancimin e shoqërisë dhe që të mos bien në grackën e varfërisë. Mënyra e përputhshmërisë duhet të përcaktohet nga ana e aktorëve relevant nacional në pajtim me kontekstin ekzistues ekonomik.

Shembulli i OMC-ës për pensionet tregon se: vendosja e përshtatshmërisë në qendër të krijimit të politikave është e mundshme dhe operative; ai e ndërlikon promovimin e qasjes së bazuar mbi të drejtën dhe përgjigjen e nevojave specifike.

46. Shih treguesit e përshtatshmërisë në ueb-faqen e Eurostatit: <http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/employmentandsocialpolicyindicators/tors/omcsocialinclusionandsocialprotection/socialinclusionstrand>

PËRSHTATSHMËRIA E TË ARDHURAVE MINIMALE GJATË KRIJIMIT TË POLITIKAVE SOT: SHEMBUJ NACIONAL TË REFORMAVE

Në periudhën e tashme, në kontekst të politikave aktive për përfshirje, një numër i madh i shteteve anëtare të BE-së kanë kaluar ose kanë inicuar diskuton për skemat ekzistuese të të ardhurave minimale. A i kanë pranuar në këtë proces sfidat e përshtatshmërisë? Si ka ndodhur kjo, dhe kush ka përcaktuar se çfarë është e përshtatshme dhe përse?

Katër nga këto reforma nacionale janë të prezantuara më poshtë (Francë, Austri, Finlandë dhe Belgjikë). Këto analiza janë të siguruara drejtpërdrejtë nga rrjetet nacionale të EAPN-ës.

EAPN vëren se reformat aktuale lidhur me skemat për të ardhurat minimale së pari e theksojnë qëllimin për t'i nxitur njerëzit që të punojnë. Qëllimi për t'ju mundësuar njerëzve një jetë të denjshme, rrallë përmendet. Mirëpo, në disa raste, tema e përshtatshmërisë ndoshta është e përmendur në margjinat e debatit me qëllim që të hapet dera për avancimin e kësaj çështjeje.

5.1 Krijimi i 'revenu de Solidarité active' ('rSa')⁴⁷ në Francë: zbatimi i Strategjisë për Përfshirje Aktive

Prapavija: mossauesi i skemave paraprake të të ardhurave minimale për t'i punësuar njerëzit.

RMI (një përkrahje e kombinuar me të ardhura/kompenzim për ato të cilët kërkojnë punë) ekziston në Francë gati 20 vjet (1988). E ka arritur qëllimin e parë, gjegjësisht t'ju mundësojë atyre të cilët janë në moshë mbi 25 vjeç të ardhura bazike për të mbijetuar. Mirëpo qëllimet e tjera ishën pjesërisht të përmbushura, gjegjësisht t'ju ndihmojë njerëzve të integrohen në shoqëri dhe gjatë punësimit.

Prandaj edhe qeveria ka vendos që ta ndryshoj, me qëllim që ta "aktivizojë shpenzimin pasiv", gjegjësisht të krijojë një lidhje më të ngushtë mes beneficioneve dhe punësimit.

47. Active-Solidarity Income.

Mjet i politikës – status dhe proces aktual: krijimi i 'rSa' ('revenu de Solidarité active')

'rSa' është skema e re e të ardhurave minimale e cila e rrit parapraken (e emruar si RMI që do të thotë shtesë për të ardhurat minimale).

Legjislacioni është miratuar në dhjetor të vitit 2008, pas përdorimit testues në fusha të ndryshme, ndërsa është zbatuar më 1 qershor të vitit 2009.

Që nga tetori i vitit 2009, rSa ce praktikohet edhe për personat e rinj nën moshën 25 vjeçare, me kusht që në tre vitet e fundit ato të kenë eksperimentuar punë prej së paku dy vjet. Paraprakisht, rSa nuk ka qenë e qasëshme për personat nën moshën 25 vjeçare.

Njerëzit të cilët jetojnë në varfëri kanë marrë pjesë në punën terrenike për krijimin e rSa, si pjesë e mekanizmit gjithëpërfshirës për qeverisje, duke përfshirë edhe aktorët kryesor.

Elementi kyç: çfarë është e re?

rSa i përforcon nxitjet për punë; të varfërit të cilët janë të punësuar do të mund pjesërisht t'u shtojnë rrogave të tyre edhe beneficione.

Niveli i të ardhurave minimale nuk është i avancuar.

Si trajtohet përshtatshmëria?

Reforma koncentrohet në shqyrtimin e çështjes mes të varfërve të cilët janë të punësuar dhe asaj që t'i nxisë kërkuesit e të ardhurave minimale që

të kërkojnë punë. **Përshtatshmëria nuk shqyrtohet nga aspekti i asaj se çfarë është e nevojshme për një jetë të denjshme, por në aspekt të asaj se çfarë është "fer" shpërblimi për njerëzit të cilët marrin pjesë në tregun e punës.**

Përparësitë dhe mangësitë e reformës

rSa padyshim se paraqet avancim për ato të cilët janë të zënë në grackën e varfërisë edhe përpos të punës që kanë, dhe të cilët do të fitojnë më shumë mjete.

Mirëpo OJQ-ët **thirrën për 25% rritje të RMI-së në një periudhë 5 vjeçare, që të mbahet hapi me rritjet e të ardhurave të personave me invaliditet dhe atyre më të moshuar, dhe që shumat të jenë të ndërlidhura me listën e shpenzimeve jetësore. Kjo nuk mund të pajtohet** për shkak se fuqia blerëse e RMI-së ka rënë shumë në krahasim me rrogën minimale.

Ankesa e madhe e OJQ-ve lidhur me rSa është se nuk i ka lehtësuar mundimet e atyre me vështirësi më të mëdha dhe ato të cilët janë më larg mundësive për të fituar punë. Asgjë e re nuk është bërë për këto grupe dhe ato do të fitojnë ndihmë më të vogël nga ato të cilët punojnë. EAPN Francë gjithashtu pendohet për elementin kushtëzues të rSa: kërkuesit do të jenë të dënuar nëse nuk arrijnë që t'i përmbahen kontratës integruese ose nëse rrefuzojnë 2 oferta pune të cilat i përputhen profilin të tyre.

Për më tepër informata:

Bruno Groues, UNIOPSS, EAPN Francë

bgroues@uniopss.asso.fr

5.2 Austri: Ligji i ri për të ardhurat minimale me testim

Mangësitë e sistemit aktual të decentralizuar

Beneficionet e mbrojtjes sociale, siqë janë ndihma sociale, beneficionet për invaliditet, shpenzimet për pension dhe kujdes shtëpiak, nuk janë nga kontributet dhe janë elemente të “shpresës së fundit” të sistemit austriak nga sigurimi social. Të financuara nga tatimet e përgjithshme, ato janë të menduara që të sigurojnë **minimale sociale në rast nevojë ose urgjence**.

Ndihma sociale (Sozialhilfe) më e rëndësishme përcaktohet, zbatohet dhe administrohet nga ana e provincave federale (Bundesländer).

Sipas Kushtetutës austriake, çdo provincë ka ligjin e saj për mbrojtje sociale (Sozialhilfegesetz), mirëpo ekzistojnë disa parime **të përbashkëta bazike**: ndihma sociale jepet në raste individuale kur mjetet e individit dhe pagesat nga pala e tretë nuk janë më të mjaftueshme për të mundësuar një mënyrë të denjshme të jetesës. Përshtatshmëria mvaret nga mjetet e amvisërisë; familjarët e tjerë kanë detyrë të sigurojnë përkrahje financiare. Të gjitha mjetet kalkuloohen me test për mjetet dhe të ardhurat (veçmas nga beneficionet familjare). Nëse kushtet e lejojnë, beneficionet duhet të kthehen, dhe atë nëse shfrytëzuesi nuk merr më ndihmë sociale (edhe pse jo të gjitha provincat e zbatojnë këtë dispozitë në praktikë).

Për shumicën e beneficioneve sociale, si dhe për ndihmën sociale, mungojnë standardet minimale. Si rezultat i kësaj, më tepër se gjysma e beneficioneve për papunësi, dhe më tepër se 80% nga beneficionet për ndihmë sociale janë nën nivelin e „Ausgleichszulagenrichtsatz” (ndihmë e cila jepet për t’i plotësuar pensionet e ulta dhe t’i rrisë ato në një nivel të caktuar).

Kërkimi i ndihmës sociale është **shumë i stigmatizuar** dhe **ka mungesë të rëndësishme të**

informatave lidhur me kriteret për përshtatshmëri. Hulumtuesit social vlerësojnë se ekziston **shkallë e mosndërmarrjes deri 50%**.

Veç kësaj, hulumtimi i bërë nga EAPN Austri tregon se kanë ekzistuar deficite të rëndësishme në shpërndarjen e ndihmës sociale. Gjithshej 17% nga OJQ-ët e anketuara kanë pasur eksperiencën që shërbimet e ndihmës sociale t’ju rrefuzojnë kërkesat për ndihmë sociale, 47% kanë raportuar se qasja në ndihmën sociale u është mundësuar pas intervenimit të OJQ-ve, ndërsa shpesh herë shuma e dhënë ka qenë nën nivelin e përcaktuar me Ligjin për ndihmë sociale.

Një sistem i ri nacional për të ardhura me kontrollim

Qëllimet kryesore të modelit të ri të sistemit për fitimin e të ardhurave minimale me kontrollim (‘Bedarfsorientierte Mindestsicherung’) janë **zbatimi i standardeve minimale dhe qasëshmëri më të mirë në transferin social**, duke përfshirë përmirësimin e shkallës së ndërmarrjes së beneficioneve. Ai model nuk i ven në pikëpyetje parimet qendrore të sistemit austriak social (psh. tendencës së tij për qasjen në tregun e punës dhe parimin e amvisërisë).

Procesi i prezantimit të sistemit austriak për të ardhurat minimale me kontrollim ka filluar përpara disa viteve, me negociata për atë se cili nivel i të ardhurave është adekuat dhe çfarë duhet të përfshihet në sistemin e të ardhurave minimale.

Qeveria paraprake ka organizuar konferenca për ta sqaruar domethënien e të ardhurave minimale me kontrollim. Qeveria e re e ka pranuar planin origjinal dhe e ka zvogluar përfshirjen pa asnjë diskutim publik.

EAPN Austri nuk ishte në mënyrë të drejtëpërdrejtë e përfshirë në formimin e reformave, mirëpo morri pjesë në krijimin e këtij ligji, si një mundësi për të bërë fushatë

për të ardhurat minimale të cilën donin ta bënin në kuadër të fushatës së EAPN-ës.

Ato kanë dhënë kontribut të rregullt përmes vlerësimit të tyre lidhur me reformat – lajmërimi në media, diskutime publike dhe kontribute në ngjarje të ndryshme publike.

Për momentin, sistemi i të ardhurave minimale në Austri është në proces të negociatave mes qeverive federale dhe nacionale. Ato janë pajtuar që data e zbatimit të jetë shtator, 2010.

Çfarë është e re?

- Krijimi i një skeme nacionale për të ardhurat minimale, duke i sinkronizuar skemat ekzistuese federale;
- Dispozita të standardizuara për të ardhurat minimale në Austri (kërkesa, dispozita për mëkëmbje, një nivel i përbashkët për të ardhurat minimale, ligj procedural);
- Përfshirja e të gjithë receipientëve në sistemin e sigurimit shëndetësor;
- Zvoglimi i të ardhurave minimale deri më 50%, nëse llogaritet se personi “nuk do” që të punojë.

Si është qasja ndaj përshtatshmërisë?

Sipas skicës së tashme, skema e të ardhurave minimale do të duhet **t’i mbulojë shpenzimet banuese dhe jetësore**, gjegjësisht t’i mbulojë shpenzimet për mjekim atëherë kur është e nevojshme, dhe të mundësojë përfshirje në shoqëri dhe kulturë. Personat individual do të duhet të kenë të drejtën që të marrin 744 euro (12 herë në muaj), që është rreth 200 euro nën vijën e varfërisë (951 euro në muaj - 2008).

Përshtatshmëria nuk ka qenë qëllimi i parë i reformës, mirëpo EAPN Austri çdoherë ka potencuar se përshtatshmërinë e merr si temë për diskutim publik.

Përparësitë dhe mangësitë

Reforma përfshin sigurim shëndetësor për të gjithë receipientët.

E kufizon detyrën për kthimin e beneficioneve kur fitohet vend pune.

Mirëpo, disa aspekte ende nuk janë kënaqëse:

- Nuk përfshin mjaft mjete për t’u mbuluar qiraja dhe shpenzimet e rrymës;
- Nuk i mbulon shpenzimet që kanë të bëjnë me nevojat e posaçme;
- Niveli i të ardhurave minimale është ende nën pragun e varfërisë;
- Ende do t’ju jepet amvisërive, dhe jo individëve;
- Ende përfshin kushtëzimin dënues në rast të aftësisë për punë.

Për më tepër informata:

Verena.fabris@volkshilfe.at

EAPN Austria: www.armutskonferenz.at

5.3 Finlanda: Reformimi i pensioneve dhe beneficioneve në vitin 2011

Historia

Sistemi aktual i mbrojtjes sociale përbëhet nga një numër i madh i beneficioneve të llojllojshme të mbrojtjes sociale, të krijuara dhe ndryshuara gjatë dekadave.

Në programin e Qeverisë (19 prill 2007), Kabineti aktual i Finlandës planifikon që ta reformojë tërë sistemin e mbrojtjes sociale.

Më tepër informata në:

www.stm.fi/en/strategies_and_programmes/sata

Mjete të politikës dhe procesit

Qëllimet e reformës janë që ta bëjnë pranimin e ofertave të punës më atraktive, ta zvoglojnë varfërinë dhe të sigurojë të ardhura minimale të përshtatshme në çdo situatë jetësore. Qëllimi i mëtutjeshëm është që ta bëjë sistemin e tërë të mbrojtjes sociale më të thjeshtë dhe më të qartë.

Reformën e përgatit Komiteti SATA, i cili përbëhet nga përfaqësues nga të gjitha sektoret relevante administrative dhe nga organizatat në tregun e punës dhe sektorin e tretë.

Komiteti e dha propozimin e tij për parimet bazike të reformës së përgjithshme në janar të vitit 2009.

Çfarë është e re?

Propozimet e Komitetit e përfshijnë të gjithë sferën e sistemit nacional të mbrojtjes sociale. Nga Qeveria më janë pranuar dy rekomandime, dhe të dy rekomandimet kishën të bëjnë me përshtatshmërinë e të ardhurave minimale:

- *Inicimi i pensionit të garantuar me qëllim që të sigurohet se pensionet më të vogla do të arrijnë një nivel të arsyeshëm (685 euro në muaj me paratë e sosit), e cila do të zbatohet nga marsi i vitit 2011.*
- *Beneficionet bazike nga sigurimi social (kompenzimi minimal, shtesa fëmimore, kompenzimi për kujdes shtëpiak, për kujdes privat ditor etj) do të ndërlidhen me indeksin e çmimeve shpenzuese. Rritja e parë e indeksit hyri në fuqi më 1 mars të vitit 2011.*

Shih: www.stm.fi/en/income_security

Si është qasja ndaj përshtatshmërisë?

Përshtatshmëria e të ardhurave minimale ishte një nga qëllimet e para të reformës. Buron nga Kushtetuta e cila thotë se secili ka të drejtën e mbijetesës dhe kujdesit bazik, sigurisë bazike materiale në rast të papunësisë, sëmundjes, invaliditetit, pleqërisë, si dhe në rast të lindjes së fëmijës ose humbjes së kujdestarit të familjes.

Koncepti i përshtatshmërisë ende nuk është definuar. Sipas mendimeve të Komitetit, një krahasim me nivelin e përgjithshëm të të ardhurave dhe standardit jetësor mund të përdoret si pikë relevante. Mirëpo në fund, ajo e cila llogaritet për të qenë standardi primar është gjyqi i rrënjësor në vlerat dhe lëndët e vendim-marrjes politike.

Komiteti sygjeron rregullën, ndërsa nga Qeveria duhet të kërkohet që ta vlerësojë përshtatshmërinë e beneficioneve bazike në çdo katër vjet, në bazë të nivelit të përgjithshëm të të ardhurave, duke marrë parasysh qëndrueshmërinë e ekonomisë publike, qëndrueshmërinë sociale dhe asaj të nevojave të tjera të ndërlidhura me zhvillimin mesatar të shoqërisë.

Përparësitë dhe mangësitë

Rekomandimet e shënuara më lartë janë të mira dhe të rëndësishme, por jo edhe të mjaftueshme. Rritja e nivelit të beneficioneve bazike është kyçe për zgjidhjen e vështirësive të atyre të cilët janë në gjendjen më të vështirë. Nëse kjo nuk realizohet, varfëria relative dhe përjashtimi social mund vetëm të rriten.

Për më tepër informata:

kirsi.vaatamoinen@stkl.fi

EAPN Finland c/o The Finnish Federation for Social Welfare and Health, www.eapn-fin.org

5.4 Belgjika: Një mjet i përgjithshëm – me planifikim kundër varfërisë

Historia

Kushtetuta e Belgjikës përcakton se “secili ka të drejtë të bëjë një jetë të denjshme” (neni 23).

Në vitin 2006, 14,7% (që është e barabartë me 1 470 000 persona) nga popullata e Belgjikës ka jetuar nën kufirin e varfërisë.

Shuma aktuale e skemave për të ardhurat minimale (726 euro në muaj për një person), e titulluar “Të ardhurat e integritit social” është **nën pragun e varfërisë** (878 euro në muaj për një person në vitin 2009).

Shërbimi publik i dedikuar për luftën kundër varfërisë, mvarësisë dhe përjashtimit social është krijuar në vitin 1999.

Plani federal kundër varfërisë

Në nivel nacional, plani kundër varfërisë ka qenë i miratuar në korrik të vitit 2008, dhe atë për vitin 2009, 2010 dhe 2011, përmes procesit të pjesëmarrjes: të gjithë ministrat (nga të gjitha 6 qeveritë në Belgjikë) dhe të gjithë aktorët e shoqërisë civile janë konsultuar. Rrjeti Belgjik Kundër Varfërisë ka qenë në mënyrë aktive i përfshirë dhe ende e ka statusin e këshilltarit të privilegjuar.

Çfarë është e re?

Disa masa janë të orientuara kah luftimi i varfërisë dhe janë të grupuara në 6 qëllime kryesore:

- Të ardhura të cilat u mundësojnë njerëzve që ta planifikojnë ardhmërinë;
- Garancion për të drejtën e shëndetësisë;
- Punësimi si burim i integritit dhe mirëqenies sociale;
- Qasje në banim;
- Qasje të garantuar në energji elektrike;
- Qasje në shërbimet publike për të gjithë.

Si është qasja ndaj përshtatshmërisë?

Pa mos u përdorur vetë fjala “përshtatshmëri”, çështja e përshtatshmërisë trajtohet nën qëllime të ndryshme të planit. Spektri i parë i masave është drejtëpërdrejtë i orientuar në rritjen e nivelit të të ardhurave: qëllimi i parë (të ardhura të cilat u mundësojnë njerëzve që të bëjnë plane për ardhmërinë) përfshin rritje të fuqisë shpenzuese përmes rritjes së beneficioneve sociale, rritjes së pensionit minimal dhe beneficioneve familjare.

Spektri i dytë i masave është i orientuar kah qasja e garantuar për të gjithë në energji elektrike. Kjo përfshin zhvillimin e tarifave sociale për energji elektrike.

Spektri i fundit i masave është i orientuar kah sigurimi i qasjes për të gjithë në shërbimet publike. Ai përfshin masa lidhur me tarifat sociale për telefon, luftë kundër ndarjes digjitale dhe tarifës së ulët për qasje në internet.

Plani për t’u rritur beneficionet sociale (duke përfshirë edhe të ardhurat për përfshirje sociale) deri në nivelin e pragut të varfërisë është i integruar nga ana e sekretarit shtetëror, gjatë përgatitjes së planit federal, mirëpo pastaj nuk është zbatuar nga qeveria.

Përparësitë dhe mangësitë

Reforma ndihmoi të arrihet konsensus mes aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë edhe sekretarin shtetëror, që të rriten beneficionet sociale me qëllim që të respektohet dinjiteti njerëzor.

Avancim lidhur me përshtatshmërinë mund të arrihet me rritjen e nivelit të të ardhurave dhe me aksionet për rritjen e efikasitetit të standardit të njerëzve të varfër.

Mirëpo në fund, qasëshmëria në buxhetin publik mbetet kriteri i vetëm.

Për më tepër informata:

Ludo Horemans,

Ludo.horemans@antwerpen.be

EAPN Belgium, www.bapn.be



KONKLUDIM

Ka vazhdimisht e më tepër dëshmi të cilat e përcaktojnë nevojën urgjente për reformimin e gjendjes ekzistuese, dhe atë lidhur me skemat e të ardhurave minimale. Edhe shkencëtarët, edhe njerëzit në terren tregojnë se sistemi aktual nuk garanton qasjen në një jetë të denjshme për të gjithë. Ky mospasurë e vendos kohezionin social në rrezik.

Një numër i madh i aktorëve përpiqen që ta tematizojnë këtë çështje, mirëpo janë bërë hapa shumë të vogël. Kjo tendencë është e dukshme përmes projekteve të orientuara kah përgjigja konkrete për domethënien e përshtatshmërisë, por edhe përmes diskutimeve politike lidhur me reformat aktuale të skemave për të ardhurat minimale.

BE-ja mund të luaj një rol të rëndësishëm, si katalizator për progres për këtë çështje, nëse shtetet anëtare pajtohen të shkojnë përprara sa i takon zbatimit të detyrave të ndërmarra në vitin 1992, në dobi të *“të drejtës bazike për mjete të mjaftueshme dhe të besueshme”*.


Rekomandimet e bëra nga Raporti i Rrjeteve të BE-së ofrojnë një avancim të rëndësishëm (shih Shtojcën 2).

Përshtatshmëria e të ardhurave minimale është në qendër të zotimeve të EAPN-ës. Ueb-faqe e posaçme (www.adequateincome.eu) i është përkushtuar fushatës së EAPN-ës për skemat e përshtatshmërisë së të ardhurave minimale për të gjithë, ku mund të gjenden informata më të hollësishme për zhvillimin e kësaj çështje, si dhe për veprimet e ndërmarra gjatë fushatës.



SHTOJCA 1: NETO TË ARDHURAT TË PËRFITUESVE TË NDIHMËS SOCIALE (2006)

Përqindja e pragut në rrezik të varfërisë për 3 lloje të amvisërive pa të punësuar, duke përfshirë edhe beneficione banuese.



Janë marrë parasyshë vetëm shtete ku ka beneficione jokategorike të ndihmës sociale.

Burim: Joint EC-OECD project using OECD tax-benefit models, and Eurostat.

SHTOJCA 2: Konkludimet dhe rekomandimet kryesore nga Raporti i rrjetit të BE-së i ekspertëve të pavarur për të ardhurat minimale nga viti 2009⁴⁹

Adequacy

1. Për shkak se nuk është e qartë se çfarë është ajo e cila e përbën përshtatshmërinë e të ardhurave minimale për një jetë të denjshme, do të jetë e dobishme nëse Komisioni Evropian dhe shtetet anëtare pajtohen mbi kriteret e përbashkëta të cilat do t'ju ndihmojnë shteteve anëtare që të sigurohen se standardi i tyre i të ardhurave minimale do t'i përmbushë kërkesat në kuadër të rekomandimeve të Këshillit të BE-së të vitit 1992, lidhur me kriteret e përbashkëta për mjete të mjaftueshme dhe ndihmë sociale në sistemin për mbrojtje sociale, si dhe rekomandimet e Komisionit Evropian të vitit 2008, për përfshirjen aktive të personave të përjashtuar nga tregu i punës. Këto kritere të përbashkëta atëherë mund ta sigurojnë bazën për raportimin dhe mbikqyrjen e përputhshmërisë së shteteve anëtare me këto rekomandime. Me qëllim që të përforcohet standardi i të ardhurave minimale në kuadër të agjendës për përfshirje aktive, mund t'i kushtohet kujdes miratimit të Direktivës Kornizë të BE-së për skemat e përshtatshmërisë së të ardhurave minimale, e cila do t'i përfshijë kriteret e përbashkëta për të cilat ekziston pajtueshmëri.

2. Të gjitha shtetet anëtare të cilat deri tani nuk e kanë bërë këtë, duhet me urgjencë të mendojnë për fillimin e diskutimit nacional për ndërtimin e konsenzusit për atë se cili nivel i të ardhurave minimale është i domosdoshëm në

shtetin e tyre, për t'u mundësuar njerëzve që të jetojnë një jetë të denjshme dhe t'i nxjerrin nga varfëria dhe përjashtimi social. Për diskutimin e tillë mund të merren informata nga kriteret e përbashkëta të sugjeruara në rekomandimin tonë të parë.

3. Si një hap i përkohshëm për të siguruar përshtatshmërinë në të gjitha SHA, të gjitha ato mund të shqyrtojnë mundësinë e përcaktimit të një qëllimi i cili në një afat të caktuar kohor (do të përcaktohet në nivel kombëtar) efekti i kombinuar i dispozitave të tyre për të ardhurat minimale dhe masat e tjera politike do të jetë i mjaftueshëm për t'i nxjerrë të gjithë personat mbi vijën e rrezikut nga varfëria në shtetin në të cilin ato jetojnë (p.sh. 60% nga të ardhurat mesatare nacionale të amvisërisë). Kjo do të jetë në pajtim me të lartpërmendurën Rezolutë të Parlamentit Evropian nga 6 maj 2009, në të cilën delegatët pohojnë se "zbatimi i Rekomandimit 92/441/EEC duhet të jetë i përmirësuar lidhur me të ardhurat minimale dhe transferin social" dhe se "ndihma sociale duhet të japë të ardhura minimale të përshtatshme për një jetë të denjshme, së paku në nivel i cili është mbi nivelin e 'rrezikut nga varfëria' dhe i mjaftueshëm për t'i nxjerrë njerëzit nga varfëria". Progresi lidhur me këtë çështje do të duhet nga afër të mbikqyret nga ana e Komisionit, dhe t'i raportohet po atij Komisioni.

49. Shih: www.peer-review-social-inclusion.eu/network-of-independent-experts/2009/minimum-income-schemes

Përputhshmëria

4. Të gjitha shtetet të cilat deri tani nuk kanë pasur mekanizëm transparent dhe efikas për t'i përmirësuar skemat e të ardhurave të tyre minimale në nivel vjetor, duhet të mendojnë që të krijojnë një mekanizëm të tillë. Ky mekanizëm duhet t'i mundësojë skemës për të ardhurat minimale që të mirëmbahet në përputhshmëri edhe me inflacionin, edhe me shtrenjtimet e standardit jetësor. Komisioni duhet ta përkrahë shkëmbimin e shkencës dhe praktikave të mira nëpër vendet e ndryshme të BE-së, për të pasur mekanizma efikase dhe në hap me kohën.

Përfshirja

5. Ato shtete anëtare me një sistem shumë të komplikuar duhet të mendojnë për thjeshtësimin e tij dhe të krijojnë një sistem më të qartë.

6. Ato shtete, skemat e të ardhurave minimale të të cilave i përjashtojnë grupet e rëndësishme të cilat jetojnë në varfëri, siqë janë ato pa shtëpi, rrefugjatët, kërkuesit e azilit, migrantët jo të regjistruar dhe romët, duhet të mendojnë për ndryshim të skemave të tyre që më mirë t'i përfshijnë këto grupe.

Mosndërmarrja

7. Të gjitha shtetet të cilat nuk e kanë bërë këtë, duhet të mendojnë për mundësimin e mbikqyrjes të niveleve të mosndërmarrjes dhe t'i gjejnë shkaqet për këtë; ato duhet gjithashtu të mendojnë për iniciimin dhe mbikqyrjen e efektivitetit të strategjive për uljen e mosndërmarrjes. Në këtë aspekt, në nivel qendror, evidenca administrative mund të përdoret për t'i zbuluar amvisëritë të cilat janë në rrezik nga varfëria, ndërsa të cilat më tutje mund të kontaktohen për t'u kontrolluar përshtatshmëria e tyre për beneficione nga të ardhurat minimale. Në vendet ku administrata është e dobët, strategjitë mund të përfshijnë iniciativa për ndërtimin e aftësive në nivelin adekuat (nacionale dhe/ose nën-nacionale), për t'i sjellë skemat e të ardhurave minimale

në mënyrë efikase dhe transparente. Veç kësaj, do të jetë e rëndësishme që të sigurohet kosekuencë gjatë interpretimit të kriterëve për përshtatshmëri, dhe me këtë të evitohet diskriminimi dhe racizmi gjatë transferimit të skemës për të ardhurat minimale.

8. Në bashkëpunim me shtetet anëtare, Komisioni mund t'i dokumentojë dhe t'i përhapë shembujt për strategji të mira të cilat janë të zhvilluara nga shtetet anëtare për ta rritur ndërmarrjen e tyre.

Destimulimi

9. Komisioni gjithashtu duhet t'i dokumentojë dhe t'i shpërndajë praktikatat e mira të cilat e paraqesin karakterin e dyfishtë, edhe atë: a) skemat për të ardhurat minimale duhet të jenë efikase në ç'rëndjesjen e destimulimit për të pranuar ndonjë vend pune, dhe ato të cilët janë në punë të kenë të ardhura të cilat i ngrejnë ato mbi varfërinë; dhe b) përshtatshmëria e skemave për të ardhurat minimale të jetë e garantuar. Kjo është e domosdoshme për të evituar atë që disa njerëz të gjenden jashtë sistemit.

Ndërlidhja e tre shtyllave të "përfshirjes aktive"

10. Shtetet anëtare të cilat ngecin duhet të mendojnë që të krijojnë një qasje më sistematike për orientimin e masave aktive në tregun e punës kah shfrytëzuesit e skemave të të ardhurave minimale, dhe t'u japin të drejtë të marrin pjesë në masat aktive dhe në zhvillimin e një sistemi më specifik, dhe më gjithëpërfshirës për përkrahje. Sigurimi i shërbimeve kualitative për përkrahje duhet të merret për të qenë aq i rëndësishëm, sa edhe përdorimi i nxitjes dhe sanksioneve financiare.

11. Ato shtete anëtare të cilat ende nuk e kanë bërë këtë, duhet t'ju sigurojnë përfituesve të skemave të të ardhurave minimale që të kenë qasje në shërbime kualitative; ato duhet edhe ta marrin parasyshtë mënyrën më të mirë për mbikqyrjen e avancimit në këtë fushë.

12.Ne bashkëpunim me shtetet anëtare, Komisioni mund t'i dokumentojë shembujt e mirë në të gjitha shtetet anëtare të cilat i ndërlidhin skemat për të ardhurat minimale me masat aktive në tregun e punës dhe qasjen në shërbime kualitative. Si pjesë e kësaj, do të jetë e dobishme të dokumentohen shembujt e praktikave të mira për të mundësuar një qasje të përshtatur në nivel lokal përmes iniciativave, gjegjësisht "sistemit njëshkollor". Kjo përsëri është një fushë ku shkëmbimi i shkenës dhe praktikës së mirë duhet të avancohet.

Mbikqyrja dhe raportimi

13.Në kontekst të MHK sociale dhe rekomandimet për përfshirje aktive nga viti 2008, Komiteti për Mbrojtje Sociale duhet ta marrë parasyshë themelimin e një sistemi transparent për mbikqyrje të rregullt dhe raportim për rolin të cilin e luajn skemat për të ardhurat minimale në sigurimin e mjeteve mjeteve dhe shërbimeve të nevojshme për një jetë të denjshme për të gjithë qytetarët.

14.Për t'ju ndihmuar shteteve anëtare dhe Komisionit në raportimin e tyre të rregullt, duhet të merret parasyshë përforsimi i rolit të sistemit të përbashkët për informim lidhur me mbrojtjen sociale (MISSOC), për një dokumentim sistematik të zhvillimit të skemave për të ardhurat minimale dhe sigurimin e tabelave krahasuese për karakteristikat e skemave të të ardhurave minimale në territorin e BE-së.

15.Si pjesë e mbikqyrjes së përshtatshmërisë, transferi efektiv i ndërmarrjes së skemave të tyre për të ardhurat minimale dhe rolet e mbrojtjes sociale, shtetet anëtare të cilat ende nuk e kanë bërë këtë, mund të zbatojnë një procedurë për përfshirje aktive të përfituesve në mbikqyrjen e rregullt të këtyre skemave.

Kriza ekonomike dhe financiare

16.Në kuadër të një krize ekonomike dhe financiare, Komisioni dhe shtetet anëtare duhet të mendojnë për atë se si duhet ta kenë rolin kyç skemat e të ardhurave minimale, si mjet për mbrojtjen e kategorive më të prekshme, dhe si një stabilizues i rëndësishëm ekonomik gjatë krizës. Kjo është pjesa kryesore e mbikqyrjes dhe reportimit të tyre për krizën.

SHTOJCA 3: Dokumentet dhe projektet kryesore lidhur me përshtatshmërinë e të ardhurave minimale

Dokumentet zyrtare të Bashkimit Evropian

Raporti sintetik për skemat e të ardhurave minimale tek anëtarët e BE-së nga ekspertët kombëtar Hju Frejzer dhe Erik Marlie, tetor 2009, si dhe raportet e ekspertëve kombëtar të cilat janë të qasëshme në ueb-faqen e **Social Inclusion Peer Review**.

Rezoluta e Parlamentit Evropian (jo e detyrueshme) për përfshirjen aktive të njerëzve të përjashtuar nga tregu i punës, maj 2009: www.europarl.europa.eu/sides/get-Doc.do?pubRef=-//EP//TEXT+TA+P6-TA-2009-0371+0+DOC+XML+V0//EN

Konkludimet e Këshillit për parimet e përbashkëta aktive për luftë më efektive kundër varfërisë më 17 dhjetor, 2008. www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/en/lsa/104818.pdf

Dokument punues i personelit të Komisionit. Progres në mbikqyrjen e qëllimeve të Strategjisë Evropiane për Mbrojtje Sociale dhe Përfshirje Sociale, tetor 2008. http://ec.europa.eu/employment-so-cial/spsi/docs/social_inclusion/2008/omc_monitoring_en.pdf

„Tendencat, zhvillimet e fundit, përfshirja aktive dhe mjetet minimale”, Raport sintetik për shqyrtimin e pavarur të bazuar mbi raportet kombëtare të ekspertëve të pavarur, semestri i parë, 2006 www.peer-review-social-inclusion.eu/network-of-independent-experts/2006/first-semester-2006?set_language=en

92 Rekomandimi 92/441/EEC i Këshillit „për kriteret e përbashkëta lidhur me mjetet e mjaftueshme dhe ndihmën sociale në sistemin e mbrojtjes sociale” <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31992H0441:EN:HTML>

Ueb-faqja e Drejtoratit të Përgjithshëm për Çështje Sociale, Punësim dhe Mundësi të Barabarta e dedikuar për Metodën e Hapur të Koordinimit: <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=753&langId=en>

Baza e të dhënave të sistemit të përbashkët informatik për mbrojtje sociale (MISSOC) ofron një varg të tabelave krahasuese për sistemet e mbrojtjes sociale në BE. Mirëpo, krahasimi i skemave nacionale për të ardhurat minimale është i kufizuar për shkak se nuk ka një definicion të përbashkët. Shih: <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=815&langId=en>

Fushata, rrjete, projekte të OJQ-ve

Fushata e EAPN-ës në dobi të skemave për përshtatshmërinë e të ardhurave minimale, me dokumente mbështetëse kyçe dhe ueb-faqe për zhvillimin e politikave të të ardhurave minimale. Shih: www.adequateincome.eu dhe www.eapn.eu

BIEN – Basic Income Earth Network është rrjet institucional i cili shërben si lidhje mes individëve dhe grupeve të dedikuar në ose të interesuara për qasjen bazike, dhe të ciliët i nxisin diskutimet për këtë çështje nëpë gjithë botën. Shih:

www.basicincome.org/bien/aboutbasicincome.html

European Consumer Debt Network është e përfshirë në projektin transnacional me qëllim të promovimit të krijimit dhe shfrytëzimit të buxheteve standarde nëpër tërë BE-në, si një instrument i rëndësishëm në luftën kundër përjashtimit social: www.ecdn.eu

Eksperiencat e **Vincetian partnership for justice** në Irlandë lidhur me buxhetet standarde: www.budgeting.ie

Projekti i **Joseph Rowntree Foundation** i shfaq shpenzimet për mbulimin e shpenzimeve bazike dhe shërbimeve për lloje të ndryshme të amvisërive: www.minimumincomestandard.org

Projekte transnacionale për standardin social:

www.eapn.ie/eapn/setting-minimum-social-standards-across-the-european-union

Projekt belgjik:

www.mensëaardiginkomen.be

Prezantime në power point:

http://onderzoek.khk.be/domein_Sociaal/EconomischBeleid/documents/PPTbudgetstandaardBereniceStorms.pdf



CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски",
Скопје

364-646.2(4-672EY)(036)

PËRSHTATSHMËRIA e të ardhurave minimale në BE : EAPN sqarues #2,
2010. - Shkup : Platforma Maqedonase Kundër Varfërisë, 2013. - 48
стр. ; 28 см

Фусноти кон текстот. - Содржи и: Dodatok 1-3

ISBN 978-608-65332-3-6

а) Социјална помош, парична - Европска унија - Водичи

COBISS.MK-ID 93069834



Që nga viti 1990, Rrjeti Evropian Kundër Varfërisë (EAPN) është një rrjet i pavarur i organizatave joqeveritare (OJQ) dhe grupeve të përfshira në luftën kundër varfërisë dhe përjashtimit social në shtetet anëtare të BE-së.

Ky Sgarues është i Kler Shampe nga Sekretariati i EAPN-ës, me përkrahje të grupit punues për përjashtim social të EAPN-ës dhe Shon Xhons nga Sekretariati i EAPN-ës. Ky dokument u ndërlidhet botimeve të disa hulumtuesve nga sfera e varfërisë dhe përjashtimit social. Referencat në detaje për ato publikime mund të gjenden në fusnotat dhe bibliografinë. Gjithashtu falemnderojmë Erik Marlier dhe Hju Frejzer për komentet e tyre të dobishme.

Përshtatshmëria e të ardhurave minimale në BE EAPN SQARUESI #2 është i përkthyer për nevojat e Platformës Maqedonase Kundër Varfërisë (PMKV), me përkrahje financiare nga Fondacioni Kombëtar për Demokraci (NED), si pjesë e projektit “Përforsimi i kapacitetit të organizatave qytetare për të marrë pjesë në procesin ligjdhënës”, i zbatuar nga Instituti Nacional Demokratik për Çështje Nërkombëtare (NDI). Mendimet e shprehura këtu janë të autorëve dhe nuk do të thotë se të njejtat i reflektojnë mendimet e NED-it dhe NDI-it.

Rrjeti Evropian Kundër Varfërisë; kopjimi lejohet vetëm nëse i bëhet referencë adekuate burimit, prill 2010.